

1 E premte, 28 janar 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [Të akuzuari hynë në sallën e gjyqit]

4 --- Seanca fillon në orën 08.00

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes.

6 Znj. Sekretare ju lutem paraqisni lëndën.

7 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Mirëmëngjes të nderuar

8 Gjykatës. Është çështja KSC-BC-2020-07, Prokurori i

9 Specializuar kundër Hysni Gucati dhe Nasim Haradinaj.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

11 Kush është nga Prokuroria?

12 Znj. Bolici.

13 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nga ZPS-ja kemi stazhierin z.

14 Benjamin Dearden.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit

16 znj. Bolici.

17 Z. Bowden.

18 Z. BOWDEN: [Përkthim] I nderuar Gjykatës, mund të shikoni

19 që z. Rees është me videolidhje, përndryshe ne nuk kemi asnjë

20 ndryshim tjetër.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mirëmëngjes

22 z. Rees.

23 Z. Cadman.

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Mirëmëngjes, të nderuar Gjykatës.

25 Me ne sot është z. Buckley, por z. Berisha është këtu.

1 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Vë re po
2 kështu që z. Gucati dhe z. Haradinaj janë të pranishëm në
3 sallën e gjyqit.

4 Përpara se të vazhdojmë z. Reid, duam që të vendosim një
5 procesverbal që Mbrojtja e Haradinajt i ka ngarkuar
6 dokumentet, të cilat janë pranuar si prova materiale me
7 dëshminë e znj. Myers: 2D7, që është Akti i Nxjerrjes së
8 Dokumenteve me Interes Publik i 1998; 2D8, që është Direktiva
9 e BE-së Nr. 1937 e 2019'; 2D9, që është rekomandimi për
10 Mbrojtjen e Sinjalizuesve nga Këshilli i Evropës; 2D10 që
11 është Ligji i Kosovës 06/L-085; dhe 2D11, që është raporti i
12 Kombeve të Bashkuara për sinjalizuesit.

13 Ju po kështu keni marrë një email me numrat e rinj të
14 provave materiale gjatë kësaj jave.

15 Trupi Gjykses po kështu vëren që disa nga këto dokumente
16 të pranuar janë dokumente legjislativë, pasi janë pranuar së
17 bashku me dëshminë e znj Myers si dëshmitare eksperte dhe nuk
18 ka pasur kundërshtim për pranimin e tyre.

19 Dhe zakonisht i gjithë legjislativoni publik apo vendimet
20 gjyqësore nuk kanë nevojë të pranohen kur qëllimi vetëm i tij
21 është që të bëhet për interpretim ligjor. Megjithatë, në
22 rastet kur ky vendim merret parasysh për një gjetje nga Trupi
23 Gjykses, ai mund të pranohet si provë materiale bashkë me
24 përmbajtjen e saj.

25 Përpara se të vazhdojmë disa çështje që janë ngritur të

1 hënën në sallën e gjyqit dhe dje me email nga Mbrojtja e
2 Haradinaj.

3 Sipas rregullit 143, marrja në pyetje është e
4 gjerësishtme. Zakonisht ka të bëjë me tematikën e marrjes në
5 pyetje dhe çështje që kanë të bëjnë me besueshmërinë e
6 dëshmitarit. Megjithëkëtë, në rastet kur dëshmitari mund të
7 japë dëshmi, të cilat janë me vlera për palën që merr në
8 pyetje, ai mund të merret në pyetje edhe për këtë çështje me
9 kushtin që avokati t'ia bëjë të qartë thelbin e pyetjes.

10 Dhe kjo është edhe rasti i dëshmitarëve ekspertë,
11 pavarësisht se pala që e ka thirrur duhet ta marrë në pyetje
12 vetëm raportin që ka paraqitur, pala që merr në pyetje palën
13 kundërshtare nuk është e detyruar ta ndjekë këtë.

14 Po kështu në bazë të rregullit 143(1) dhe paragrafit 67
15 të Urdhrit të Procedurave pala që merr në pyetje në parim mund
16 të paraqesë dokumente të ndryshme pavarësisht nëse janë
17 pranuar apo jo, vetëm me kusht që të jenë nxjerrë më parë dhe
18 duke patur parasysh këtë në vlerësojmë në mënyrë të veçantë
19 të gjitha rreziqet që kanë të bëjnë me një dëshmitar dhe
20 marrjen e tij në pyetje. Për sa i përket pikës së ngritur nga
21 ZPS-ja për dokumente të cilët nuk kanë dhënë dëshmi
22 dëshmitarët, paneli e vëren se, e përsërit edhe njëherë që
23 vërtet dhe besueshmëria e këtyre dokumenteve mund të
24 kontrollohet vetëm përmes autorëve të tyre. Por këto dokumente
25 mund të përdoren për të testuar besueshmërinë e dëshmitarit

1 aktual dhe besueshmërinë e raportit të tij.

2 Dhe pyetjet që bëhen nga ZPS-ja duhet t'i përmbushen
3 këtij rregulli.

4 Tani t'i kërkojmë që të paraqitet dëshmitari.

5 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit përmes
6 videolidhjes]

7 [Z. Reid në ekran]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Mirëmëngjes z. Reid.

9 Jemi gati që të vazhdojmë me pjesën tjetër të seancës së
10 marrjes në pyetje. A jeni i gatshëm?

11 DËSHMITARI: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, jam i
12 gatshëm.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund të
14 dëgjoni?

15 DËSHMITARI: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Po, dëgjoj
16 shumë mirë.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dakord.
18 Znj. Bolici ju e keni fjalën.

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Mirëmëngjes, i nderuar Gjykatës.

20 DËSHMITARI: ROBERT REID [Rifillon]

21 [Dëshmitari dëshmon përmes videolidhjes]

22 Pyetje të palës tjetër znj. Bolici: [Vijon]

23 Py. Mirëmëngjes z. Reid.

24 Pë. Mirëmëngjes.

25 Py. Dëshiroj që t'i kthehem raportit tuaj DNH0587 dhe

1 DNH0868. Dhe kryesisht paragrafit 14, i cili ndodhet në
2 paragrafin DNH0861 [sipas përkthimit].

3 Në këtë paragraf ju keni përshkruar operacionin e
4 konfiskimit të cilin e keni drejtuar në dhjetor të vitit 1997
5 në Bashkinë apo Komunën e Prijedorit në Bosnjë-Hercegovinë,
6 kështu është?

7 Pë. Po.

8 Py. A keni konsultuar -

9 DËSHMITARI: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Më falni ju
10 dëgjoj me shkëputje.

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

12 Py. Z. Reid, a më dëgjoni?

13 Pë. Po, tani po.

14 Py. Besoj se ka pak vonesë sinjali.

15 Py. A keni shqyrtuar dokumente kur keni përshkruar këto
16 operacione në raportin tuaj apo këtë paragraf e keni shkruar
17 duke u bazuar mbi kujtesën tuaj?

18 Pë. Ju nuk i jam referuar asnjë dokumenti. Kjo është thjesht
19 nga kujtesa ime dhe është në përputhje me praktikat dhe
20 procedurat

21 Py. Sa e mirë është kujtesa juaj për ngjarjet e ndodhura para
22 24 viteve?

23 Pë. Nuk është aq e mirë sa ç'ka qenë para 24 viteve.

24 Megjithëkëtë më kujtohet në mënyrë të veçantë ky mision, pasi
25 ishte misioni i parë i kësaj shkalle që ne kemi ndërmarrë, por

1 më ka ngelur në mendje, në kujtesë.

2 Py. Në pjesën e dytë të paragrafit 14, ju keni thënë që është
3 bërë kontrolli i një numri ndërtesash. Ju kujtohet sa ka qenë
4 numri i ndërtesave?

5 Pë. Po, besoj që ishin tre. Ishte stacioni i policisë dhe
6 ndërtesa e bashkisë, pasi unë vetë kam drejtuar misionin në
7 ndërtesën e bashkisë dhe një nga udhëheqësit e tjerë të ekipit
8 ka shkuar te stacioni i policisë. Për sa i përket selisë së
9 SDS-së, së Partisë SDS, nuk më kujtohet mirë por ka qenë
10 vërtetë në listën e ndërtesave që duheshin kontrolluar.

11 Pë. Gjatë dëshmisë suaj të fundit më datën 24 janar, ju
12 përmendët ndërtesën e bashkisë, selisë e SDS-së dhe stacionin
13 e policisë dhe kjo ndodh në faqen 3213 deri në 3218. A nuk
14 është kontrolluar edhe stacioni i radios gjatë të njëjtit
15 operacion?

16 Pë. Jo, nuk më kujtohet saktë nëse ka qenë selia e partisë
17 apo e radios. Ju keni të drejtë, mund të ketë qenë stacioni i
18 radios, pasi tani që më kujtoni juve, më kujtohet që kemi
19 sjellë me vete disa kasete, të cilat nuk kemi qenë në gjendje
20 që t'i transkriptonim për të marrë vesh se për çfarë bëhej
21 fjalë. Po tani që më kujtoni ju, po, ka shumë mundësi të ketë
22 qenë Radio Prijedor dhe jo ndërtesa e SDS-së.

23 Py. Pra ishin katër?

24 Pë. Po, fillimisht ne kemi dashur të, -- kemi pasur urdhër
25 kontrolli për katër. Por tani që ju po më kujtoni më mirë,

1 besoj se kanë qenë tre dhe unë e kisha gabim. Pra janë tre dhe
2 besoj se ka qenë Radio Prijedor.

3 Py. A ka marrë pjesë në këto operacione të kontrollit dhe të
4 konfiskimit edhe z. Mazhar Inayat?

5 Pë. Po. Po ai besoj se ka shkuar tek stacioni i policisë.

6 Py. Z. Reid, të shohim transkriptin e dëshmisë që dha Inayati
7 në çështjen Brdjanin në TPNJ më datë 28 janar 2002.

8 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Ky është një dokument me numër
9 prove IT-99-36, T924 deri në T1007 dhe në faqen 977 të
10 transkriptit.

11 Py. Po pres që dokumenti të paraqitet në ekran.

12 Py. Po. Nuk isha në gjendje që t'i printoja këto dokumente.

13 Py. Hidhi një sy rreshtave nga 21 deri në 25.

14 Pë. Po.

15 Py. Dhe pyetja e Prokurorit, ku thuhet - po e filloj me
16 rreshtin 16.

17 Py. "A mund të kontrollojmë së pari konfiskimin që është bërë
18 në qytetin e Prijedorit së pari? Kur ndodhi e para?"

19 Përgjigje:

20 "Kjo ndodhi më datën 12 dhjetor 1997".

21 Pyetje:

22 "Dhe në cilat vende është zhvilluar ky operacion"?

23 Dhe përgjigjja ishte që:

24 "Ekipi kërkoi katër ndërtesa në Prijedor, në qytetin e
25 Prijedorit. Këto ishin ndërtesa e bashkisë, stacioni i

1 policisë, zyrat e SDS-së dhe më në fund stacioni i radios i
2 cili ndodhet në Kozarski Vjesnik".

3 A e pranoni tani që është bërë kontrolli i katër
4 ndërtesave, edhe i SDS-së edhe i stacionit të radios? A
5 përputhet kjo me kujtesën tuaj?

6 Pë. Me sa më kujtohet mua, ne kemi kontrolluar si në mënyrë
7 të saktë ndërtesën e bashkisë, të stacionit të policisë dhe
8 tani që më kujtohet mua ishte Radio Prijedor, e cila kishte
9 dhe gazetën Kozarski Vjesnik.

10 Por nëse kemi kontrolluar apo jo ndërtesën e SDS-së nuk
11 më kujtohet. Tani që më thatë ju për Radio Prijedorin, m'u
12 kujtuan kasetat. Por nuk jam i sigurt nëse kemi patur kohën
13 apo forcat për ta bërë këtë.

14 Por n.q.s. Mazhari e ka thënë këtë në vitin 2002, nuk kam
15 problem.

16 Py. Pra kur e keni shkruar raportin tuaj, ju nuk keni
17 kontrolluar nëse ky raport, ky ishte i saktë apo jo?

18 Pë. Unë e kam shfrytëzuar si një shembull për të evidentuar
19 mënyrën sesi është bërë kontrolli dhe konfiskimi dhe sesi e
20 kemi zbatuar zinxhirin e ruajtjes së këtij dokumentacioni.

21 Py. Pra keni shkruar që ishin tre, ishin tre vende të
22 kontrolluara por nuk keni kontrolluar nëse ishte e saktë?

23 Pë. Jo e mora nga kujtesa ime.

24 Py. Dhe kujtesa juaj nuk ishte e saktë pasi e keni kuptuar
25 tashmë që dëshmia e z. Inayat është e saktë?

1 Pë. Po, unë e pranoj dëshminë e z. Inayat edhe siç pranova
2 edhe atë që më thatë juve për Radion Prijedor. Pra ju më
3 kujtuat këtë dhe mund kujtuan edhe kasetat. Po, e pranoj.

4 Py. Në paragrafin 14, të raportit tuaj, ju thatë që nuk është
5 bërë inventari i hollësishëm i ndërtesave ku është bërë
6 kontrolli dhe konfiskimi për shkak të arsyeve të sigurisë.

7 Ju nuk keni bërë inventar të hollësishëm për shkak se ka
8 patur arsye përse nuk mund të bëhej një gjë e tillë?

9 Pë. Po. Në ndërtesën ku është bërë kërkimi, po, ashtu është.

10 Py. Pra ju nuk e keni menduar që fakti që nuk është bërë
11 inventari i saktësishëm atje nuk ka ndikuar me integritetin e
12 pavërtetësinë e dokumenteve?

13 Pë. Jo, sepse ne e dinim se çfarë kishim marrë dhe bëmë
14 inventarin në Selinë Ushtarake në Banja Luka.

15 Py. Ju nuk bëtë inventar të hollësishëm në vendin e ngjarjes
16 apo jo?

17 Pë. Po.

18 Py. Dhe ju do ta kishit menduar që - po ta kishit menduar që
19 kjo do të ndikonte mbi integritetin e dokumentacionit, do ta
20 kishit bërë në terren apo jo?

21 Pë. Po, po të ishte një situatë ideale, do ta kishim bërë
22 ashtu. Por morëm këshillën e këshilluesve ushtarakë, të cilët
23 ishin të shqetësuar që kishim qenë për një kohë të gjatë në
24 atë ndërtesë dhe kishin filluar të vinin turma në rrugët e
25 Prijedorit; dhe siç e dini ne morëm këshillën e ekspertëve.

1 Ne e kishim marrë dokumentacionin. Ne e vendosëm atë në qese
2 të provave materiale. E vendosëm në kuti të provave materiale,
3 bëmë fotografimin, bëmë videon dhe e dërguam tek selia
4 ushtarake për të bërë inventarin e plotë.

5 Py. A është e saktë që në fillim keni dëshiruar, apo donit ta
6 bënit këtë inventar të saktë por në drekë e kuptuat që nuk
7 kishit patur kohë të mjaftueshme për të vazhduar në këtë
8 mënyrë dhe vendosët që ta bënit që këtë hap ta kalonit, kështu
9 është?

10 Pë. Nuk më kujtohet nëse ka qenë mesditë apo jo. Nuk më
11 kujtohet koha kur kemi shkuar. Mendova se kemi shkuar në mes
12 pasdite, por n.q.s. ka dokument që thotë që kemi shkuar, kemi
13 ikur në mesditë, dakord.

14 Py. Jo, jo, ju e kuptuat mesditë; që nuk ka patur kohë për ta
15 bërë këtë inventar që kishit dashur ta bënit që në fillim, që
16 koha nuk ishte e mjaftueshme dhe prandaj nuk e bëtë inventarin
17 e hollësishëm.

18 Pë. Jo, ne do kishim shkuar deri në orën 9.00 të darkës për
19 ta bërë inventarin, por ne morëm thjesht këshillën e
20 ushtarakëve për të ikur nga këto ndërtesa për të shkuar në
21 bazën ushtarake dhe kjo për arsye të sigurisë. Jo, jo unë isha
22 i lumtur që të qëndroja atje deri në 9.00 të darkës për të
23 bërë inventarin.

24 Py. Po ju freskoj kujtesën edhe një herë me dëshminë e z.
25 Inayat.

1 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Referenca është e njëjtë, faqet
2 përkatëse janë 982 dhe 983.

3 Py. Në rreshtin 24 të faqes 982 dhe në bazë të dëshmisë që ka
4 dhënë z. Inayat, ai tha:

5 "...Më duhet të them që kur kemi filluar procesin e
6 kontrollit dhe të konfiskimit kishim shpresuar që secilin
7 dokument ta përshkruanim në hollësi, por në ditën e caktuar
8 kuptuam që numri i madh i dokumenteve që do konfiskonim nuk do
9 ta bënte të mundur një gjë të tillë. Kështu që, ndërkohë që
10 dosjet po vinin, po më vinin mua unë i kam regjistruar në
11 formularin e regjistrimit dhe i merrja nën kontroll".

12 Por në fakt, inventari nuk është bërë, për shkak se në
13 mesditë ju e kuptuat që nuk kishte patur kohë?

14 Pë. Ndoshta këtë ka kuptuar z. Inayat në stacionin e
15 policisë, por ne kemi qenë, kemi mbetur në komunikim e sipër
16 njëri me tjetrin edhe me gjeneralin, që ishte përgjegjës i
17 misionit ushtarak, i cili tha që kishte filluar të shqetësohej
18 për shkak të turmave që po mblidheshin në rrugë.

19 Nëse e kam dërguar mesazhin e z. Inayat në atë moment apo
20 jo nuk më kujtohet.

21 Pë. Por ka shumë mundësi që ky të jetë vendimi që ka marrë z.
22 Inayat në stacionin e policisë. Ai ishte personi përgjegjës
23 për stacionin e policisë dhe ka patur pavarësinë e vet në
24 ushtrimin e këtij roli.

25 Py. Si rezultat i këtij vendimi, personi i cili i ka marrë

1 këto dokumente në vende të ndryshme, nuk ka patur inventar të
2 dokumenteve të konfiskuara faqe për faqe, një nga një?
3 Pë. Po, atë e kam marrë të nesërmen. Dhe nuk besoj që ka
4 ndodhur faqe pas faqeje. Kjo do të kishte qenë e pamundur. Për
5 shkak se - nëse më kujtohet si duhet - në Prijedor janë
6 konfiskuar me dhjetëra faqe dokumentesh.

7 Kështu që ajo bënim në këto raste, po të kishim një nga
8 dosjet e mëdha, aty kishte një përshkrim - ndoshta për
9 shembull thuhet, ta zëmë - rojet në stacionin policor të
10 Kozaracit dhe kështu e kemi përshkruar. Mund të ketë patur 20
11 faqe në atë dosje, po nuk më kujtohet sesa, se çfarë
12 dokumentesh kanë qenë.

13 Py. Nuk ju kujtohet?

14 Pë. Jo, nuk më kujtohet. Pra n.q.s. kishin qenë në regjistrat
15 e rojes, kështu do t'i shpjegonim dhe do t'i vendosim në krye
16 të kësaj dosje të madhe.

17 Py. Dhe personat në stacionin e policisë, kanë patur njohuri
18 të plota se cilët ishin dokumentet që ishin konfiskuar. Pra ju
19 po përshkruani dosjen, grupin e dokumenteve apo jo?

20 Pë. Po.

21 Py. Personat, të cilëve u janë konfiskuar dokumentet nuk kanë
22 patur mundësi që të japin mendimin e tyre lidhur me
23 përmbajtjen e këtyre dokumenteve që ndodheshin në secilën prej
24 këtyre dosjeve. A është kështu apo jo?

25 Pë. Individët - dhe nuk di nëse, nuk di për stacionin e

1 policisë, nuk di nëse stacioni i policisë, kryetari apo shefi
2 i policisë ka qenë atje gjithë kohës. Por më kujtohet që unë
3 kam folur me kryetarin e bashkisë në ndërtesën e bashkisë. Por
4 siç ju thashë, të hënën kemi patur oficerë të policisë nga
5 Republika Serbska, të cilët ishin pjesëtarë të ekipeve tona të
6 kontrollit dhe ata kanë ditur ekzaktësisht se çfarë kemi bërë
7 dhe ç'dokumente kemi marrë.

8 Py. Pra, por personat që kanë qenë të pranishëm nuk kanë
9 patur mundësinë që të përshkruajnë në hollësi se çfarë
10 përmbanin në dokumentet që ju kishit konfiskuar, kështu është?
11 Pë. Po.

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po i referohem dëshmisë së z.
13 Inayat në këtë çështje dhe ky është transkripti IT-99-36 T1108
14 deri në T1104 dhe faqja 1061.

15 Py. Në përgjigje të pyetjes së avokatit në rreshtin 6. Ju
16 kërkoi ndjesë. Vetëm një çast ju lutem.

17 Pë. Dakord.

18 Py. Do ta kalojmë këtë referencë. Personi, i cili i ka marrë
19 dokumentet nuk ka patur mundësinë për t'i inspektuar një nga
20 një se çfarë përfaqësojnë apo se çfarë përfaqësonte secila
21 faqe në këto dosje apo jo?

22 Pë. Po. Mesa më kujtohet, po.

23 Py. Dhe në bazë të rrethanave, kjo ishte në përputhje me të
24 gjithë udhëzuesit që kishte bërë Prokuroria e TPJN-së për sa i
25 përket metodës më të mirë për këto operacione të kontrollit

1 dhe të konfiskimit. Standardi ishte që do të bëhej inventari
2 në vendin ku janë marrë dokumentet, por siç e thashë duhet të
3 marrësh parasysh këshillën më të mirë dhe këtë kemi bërë. Ne u
4 larguam nga këto ndërtesa, shkuam dhe bëmë inventarin tek
5 selia ushtarake apo tek baza ushtarake dhe i morëm me vete.

6 Py. Pra ju zbatuat pikërisht situatën specifike. Nuk ka
7 menduar që kjo ka ndikuar në besueshmërive e dëshmime që keni
8 konfiskuar.

9 Pë. Po, besueshmëria dhe vërtetësia është çështje e ndryshme.
10 Por nuk besoj se ka ndryshuar në zinxhirin kontrollues, e
11 kontrollit.

12 Py. Faleminderit. Po kur bëhet fjalë për 1.000 faqe, besoj se
13 besoni se duhet dy minuta për çdo faqe për të bërë një
14 inventar dhe jo një inventar shumë të hollësishëm?

15 Pë. Po n.q.s. bëhet fjalë për dokumente individuale, n.q.s.
16 është një raport mbi 30 faqe a kështu mundet ta marrësh si
17 inventar, mund ta vendosësh thjesht në një dosje apo në një
18 zarf thjesht me një përshkrim.

19 Py. Por n.q.s. mendojmë një dokument, i cili ka 1.000 faqe
20 dhe të gjitha janë në dokumente individuale, siç ishte Paketa
21 Numër 1, ninimalisht do të kërkoheshin dy minuta për secilën
22 faqe për ta përshkruar.

23 Pë. Ndoshta, ndoshta. Mesa di unë kjo Paketa 1, mesa di unë
24 pra ka patur letra dhe emra të dëshmitarëve kështu me radhë.

25 Py. Pra nëse nuk jam gabim do të duheshin 2.000 minuta për të

1 bërë këtë inventar, më shumë se 33 orë. Dhe besoj se jeni
2 dakord që do të ishte problematike që operacioni i kontrollit
3 dhe i konfiskimit të zgjatet deri në 33 orë, vetëm për vetëm
4 për t'u bërë inventari në terren?

5 Pë. Po. Dhe prandaj e kemi bërë inventarin në mënyrën si e
6 kemi bërë.

7 Py. Faleminderit. Një nga arsyet se përse nuk është bërë
8 inventari i saktë në vendin e konfiskimit është për shembull
9 që një numër i madh i materialeve janë në një gjuhë, të cilën
10 nuk e kuptojnë, nuk e kuptojnë anëtarët e ekipit që kanë bërë
11 këtë operacion.

12 Pë. Po dhe prandaj kemi patur ndihmës gjuhësorë me vete. Në
13 çdo operacion të tonin kemi patur një numër të madh
14 specialistësh që na kanë ndihmuar, përfshirë hetues, avokatë,
15 persona që janë marrë thjesht me kërkimin dhe kështu me radhë.

16 Py. Po në operacionin tuaj të 1997-s, hetuesit nuk ishin në
17 gjendje që të përshkruanin të gjitha materialet në gjuhën
18 boshnjake dhe në vendin e ngjarjes apo jo?

19 Pë. Nuk jam krejt dakord me këtë, për shkak se kemi patur
20 ndihmës gjuhësorë, të cilët kanë punuar në këtë ndërtesë të
21 policisë dhe në bashki, të cilët na kanë përshkruar se çfarë
22 ka në këtë raft. Kemi bërë shkurt, kemi bërë një inspektim të
23 shpejtë të dosjeve se çfarë ka në ato dosje dhe na kanë
24 shpjeguar se çfarë është ky dokumentacion, të cilin ne e kemi
25 konfiskuar më pas. Ata luajnë një rol shumë të madh. Po ju

1 keni të drejtë, unë nuk e kam kuptuar gjuhën boshnjake.

2 Py. Për të bërë një inventar të hollësishëm për t'ia dhënë

3 një personi, i cili e ka bërë këtë, ndonjë gjë që nuk e

4 kuptonit, atëherë do të duhej ndihma e një përkthyesi për të

5 parë të gjitha dokumentet një për një me qëllim që të bëhet në

6 fund inventari i saktë?

7 Pë. Ne kemi patur me vete një numër të madh përkthyesish, nuk

8 ishte vetëm një. Kemi patur në secilin ekip, kemi patur një

9 numër oficerësh të kërkimit dhe të kontrollit dhe po aq ishte

10 dhe numri i përkthyesve.

11 Py. Dhe ky ishte një operacion, që ishte i planifikuar me

12 disa javë përpara apo jo?

13 Pë. Po, disa javë përpara.

14 Py. Po n.q.s. operacioni i kontrollit dhe konfiskimit do të

15 duhej të bëhej nën trysinë e kohës, atëherë mund të ishte

16 problematike gjetja e numrit të duhur të përkthyesve apo jo? A

17 jeni dakord?

18 Pë. Mundet.

19 Py. Gjatë këtyre operacioneve të kontrollit dhe të

20 konfiskimit, të cilët keni përkthuar. Ju na thatë që të

21 nesërmen keni shkuar tek autoritetet, të cilave ia keni

22 konfiskuar dokumentet dhe u dhatë atyre një inventar më të

23 mirë?

24 Pë. Kur jua dhatë këtë inventar, kur jua dhatë këtë inventar,

25 ju nuk i sollët me vete dokumentet me qëllim që ato të mund të

1 kontrollonin nëse ky inventar ishte i saktë?

2 Pë. Jo. Me sa më kujtohet mua jo.

3 Py. Pra ju thjesht u dorëzuar një dokument që e kishit
4 hartuar ju vetë. Dhe ata nuk mund të ishin në gjendje që ta
5 kontrollonin për ta verifikuar nëse ishte në përputhje me
6 dokumentet që ishin konfiskuar një ditë më parë apo jo?

7 Pë. Po, e saktë është.

8 Py. Pra në fakt personi që mund t'i ketë sekuestruar nuk mund
9 të kishte verifikuar që inventari përkonte me dokumentet që
10 ishin sekuestruar?

11 Pë. E saktë.

12 Py. Na treguat në dëshminë tuaj të datës 24 janar të vitit
13 2022, se në disa raste të caktuara, u keni dhënë autoriteteve
14 nga të cilat janë sekuestruar dokumentet kopje të skanuara që
15 i kishit marrë; për shembull dosje administrative që kishin të
16 bënë me personelin ushtarak. Këto ishin dokumente, të cilat
17 autoritetet prej të cilave i sekuestruat ishin të autorizuar
18 që t'i mbanit, t'i zotëronit. Për këto dokumente bëhet fjalë
19 apo jo, se ishin të tyre?

20 Pë. Po. Këto dokumente i përkisnin Ushtrisë së Republikës
21 Serbska, po.

22 Py. A e kuptuat se një prej qëllimeve të kontroll-
23 sekuestrimit që është kryer më datë 8, 17 dhe 22 shtator ishte
24 që të hiqej zotërimi, pra të akuzuarve të mos i kishin më, të
25 akuzuarit të mos i kishin më në dorë këto dokumente?

1 Pë. Po.

2 Py. Duke pasur këtë parasysh, a jeni dakord nëse them që
3 dhënia e kopjeve të informacioneve dhe të materialeve që
4 pretendohet se të akuzuarit nuk kishin të drejtë që t'i
5 mbanin, bie ndesh me vetë qëllimin e kontroll-sekuestrimit?
6 Pajtoheni me këtë?

7 Pë. Po, por mendoj se mund të jepej një listë e përgjithshme
8 se çfarë kishin pasur pa dhënë hollësitë.

9 Py. Faleminderit. Në paragrafin 14, të raportit tuaj,
10 shkruani kështu:

11 "Duke qenë se - pra gjatë sekuestrimit të
12 dokumentacionit, u regjistruan në formularët e caktuar -
13 fotografitë dhe videot janë vendosur në qeset e provave dhe
14 pastaj në kutitë e provave".

15 A jeni i sigurt që kjo është procedura e cila është
16 ndjekur?

17 Pë. Po, ishte në ndërtesën komunale.

18 Py. Dhe në të njëjtën mënyrë, jeni të sigurt që të tre
19 vendndodhjet ku është bërë kërkimi?

20 Pë. Jo. Unë isha i ngarkuar me detyrën e kontrollit të bërë
21 tek ndërtesa komunale. Kështu që unë mund të flas në mënyrë
22 kategorike për atë. Pastaj nëse i është futur njëherë në qese
23 të provave dhe pastaj këto janë futur në kuti, kjo s'më
24 kujtohet me saktësi. Por dokumentacioni gjithsesi është
25 dokumentuar gjatë kryerjes së kontrollit.

1 Py. Më 24 janar, në faqen 3224 të transkriptit në rreshtat 15
2 deri në 18, ju keni thënë:

3 "Tani nuk më kujtohet nëse kam përdorur apo jo qese të
4 provave. E di se kur jemi kthyer në Zagreb, ne kishim kuti por
5 mund të ketë qenë që qeset e provave mund të jenë futur në
6 kuti".

7 Pra nuk ju kujtohet në të vërtet nëse janë përdorur apo
8 jo qeset? A është e saktë kjo?

9 Pë. Po unë këtë thashë.

10 Py. Por ju në raport keni shkruar që:

11 "Ndërkohë që dokumentacioni sekuestrohej, regjistrohej në
12 formularët përkatës, është fotografuar, është marrë në video,
13 është vendosur në qese të provave dhe pastaj është futur në
14 kutitë e provave".

15 Pra në fakt juve nuk ju kujtohet nëse janë vendosur në
16 qese provash, apo jo?

17 Pë. Kështu më kujtohet. Po edhe njëherë siç e thashë është
18 mbas 24 vjetësh.

19 Py. Saktësisht.

20 Pë. Pra është ose në qese provash dhe në kuti provash ose në
21 qese provash ose kuti provash.

22 Py. Pra në raportin tuaj ju thoni që: "pastaj është futur në
23 kuti provash"?

24 Pë. Po.

25 Py. Po të hënën ju thatë në fakt se nuk ju kujtohet nëse janë

1 përdorur qese provash apo jo. Jeni dakord me këtë përgjigje?

2 Pë. Po, po.

3 Py. Po ju shkruani gjithsesi se janë vendosur në qese
4 provash.

5 Pë. Epo mua kështu më kujtohej asokohe.

6 Py. Në momentin kur keni shkruar në raportin kështu ju
7 kujtohej?

8 Pë. Po, kështu më kujtohej kur kam shkruar raportin.

9 Py. Dhe ditët e fundit, ju e keni fituar një pjesë të
10 kujtesës? Nuk keni më dyshime për atë që ju kujtohet?

11 Pë. Jo, jo. Nuk kam dyshime për ç'ka më kujtohet. Dua të them
12 që besoj se kështu kemi vepruar të paktën në ndërtesën
13 komunale, kemi përdorur qese provash dhe këto pastaj i kemi
14 futur në kuti provash.

15 Py. Por nuk jeni i sigurt për këtë?

16 Pë. Nuk mund t'ju them - nuk di ç'tu them tjetër veçse ç'ju
17 thashë.

18 Py. Pra po dëshmoni se nuk mund të jeni preciz për këtë.

19 Pë. Nuk jam, nuk mund të jem 100 për qind i saktë.

20 Py. Ju thoni që dokumentet janë fotografuar dhe marrë në
21 video. Jeni i sigurt që janë marrë me fotografi dhe me video
22 përpara se të futeshin në kutitë e provave?

23 Pë. Kam thënë "dhe/ose" janë marrë në video.

24 Py. Mirë, po jeni të sigurt që është bërë ky lloj dokumentimi
25 fotografik?

1 Pë. Po, po. Në ndërtesën komunale, po, mendoj se po, kemi
2 bërë fotografi.

3 Py. Po kjo vlen vetëm për një ndërtesë, në ndërtesën ku keni
4 qenë. Nuk jeni i sigurt nëse kjo mund të jetë bërë dhe në
5 vendndodhjen ku ishte z. Inayat për kontroll-sekuestrimin?

6 Pë. Jo, s'mund ta them se s'ishte aty.

7 Py. Siç thatë ju dhe s'mund të thoni se çfarë ndodhi aty?

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju lutem bëni
9 një pauzë. Pas pyetjes z. Reid bëni një pauzë para se t'i
10 përgjigjeni pyetjes.

11 Z. REID: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë i nderuar Gjykatës.
12 [sipas përkthimit].

13 DËSHMITARI: [Përkthim] Unë shkova në stacionin e policisë
14 herët në mëngjes dhe kam dorëzuar urdhrin e kontrollit shefit
15 të policisë në detyrë dhe pastaj u largova nga stacioni bashkë
16 me punonjësit e policisë të cilëve iu ngarkua detyra për të
17 kryer kontrollin dhe mendoj se kaluam rrugën, mendoj se
18 ndërtesa komunale ishte brenda një distance që bëhej më këmbë.
19 Pastaj u ktheva në stacionin e policisë. Pastaj fola me z.
20 Inayat dhe kur ai u kthye në zyrat qendrore në Banja Luka.

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim]

22 Py. Në rregull. Pra ju po bënit koordinim siç thoni të
23 kontrollit dhe kërkimit, të kontrollit dhe sekuestrimit në të
24 gjitha vendndodhjet. Pra kjo është diçka që ju e keni
25 kontrolluar, por nuk është diçka që keni treguar vëmendjen

1 nëse janë regjistruar me fotografi dhe video, kështu?

2 Pë. Jo se s'kam treguar vëmendje, po i tregoja më shumë
3 vëmendje në atë se çfarë kemi bërë në ndërtesën komunale. Nëse
4 z. Inayat do të ketë pasur ndonjë problem, ai do të më kishte
5 dërguar mesazh, do të më kishte dërguar fjalë. Tani nëse ai
6 vendosi apo jo që të bënte fotografi dhe/ose video nuk e di.
7 Nuk më kujtohet tani.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Bolici,
9 ju vazhdoni që ta ndërprisni ndërkohë që ai flet. Ju lutem
10 prisni derisa të mbarojë përgjigjja.

11 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Patjetër, i nderuar Gjykatës. Ju
12 kërkoj ndjesë.

13 Py. Z. Inayat kishte autonominë që të vendoste për të mos
14 bërë fotografi apo video të dokumenteve përpara se t'i fuste,
15 përpara se t'i merrte më saktë dhe kjo ishte në përputhje me
16 praktikën e Zyrës së Prokurorit. Pra me OTP-në. Kështu?

17 Pë. Kishte autonominë, po kishte pavarësinë të bënte atë që
18 ishte më e mira sipas mendimit të tij. Nëse ishte diçka e cila
19 do ta pengonte që ta bënte këtë gjë, ose nëse ishte diçka që
20 mund t'ia ngadalësonte procesin dhe nuk do e lejonte që të
21 kryente kontrollin deri në fund, atëherë po do ta kishte marrë
22 këtë vendim.

23 Py. Sepse mosbërja e fotografive të çdo dokumenti në këto
24 mjedise, nuk do të cenonte suksesin e kontrollit dhe
25 sekuestrimit, kështu? Pajtoheni?

1 Pë. Pajtohem pjesërisht. Por nxjerrja në fotografi dhe/ose në
2 video do të kishte qenë shumë më mirë, por jo nuk do të
3 cenonte zinxhirin e ruajtjes së dokumentacionit.

4 Py. Faleminderit. Dëshiroj tani që t'i referohem transkriptit
5 të dëshmisë në TPNJ-në të z. Inayat.

6 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Në veçanti për dokumentin IT-99-
7 36 dhe T924 deri në T1007. Është faqja me numër 983. Në
8 veçanti është rreshti 12.

9 Kur i referohet procesit të kontroll-sekuestrimit që ka
10 kryer ai thotë se:

11 "Përpara se kutitë të transportoheshin, a janë vulosur
12 këto kuti"?

13 Ai përgjigjet se -- kjo ishte pyetja.

14 Përgjigjja është:

15 "Po. Besoj se po që kutitë janë vulosur. Por procedura e
16 duhur për vulosjen e materialeve është kryer më vonë, në
17 bazë".

18 A ju kujtohet që në fakt dokumentet janë larguar nga
19 mjediset ku janë sekuestruar, janë kontrolluar më pas në një
20 vend të sigurt dhe pastaj janë vulosur me procedurën e duhur
21 për t'i transportuar materialet deri në Hagë. Ju kujtohet kjo?

22 Pë. Po, po, besoj se këtë ka dashur të thotë ai që i është
23 bërë një vulosje kutive në stacionin e policisë apo në
24 ndërtesën komunale, janë çuar në bazën në Banja Luka, ku u
25 është hequr vula, është bërë inventari që na ka dhënë

1 mundësinë që edhe të bëjmë procesverbalin e lëvizjes përgjatë
2 zinxhirit të ruajtjes. Dhe pasi është bërë kjo, janë rivulosur
3 dokumentet në kuti dhe janë dërguar pastaj në Hagë.

4 Py. Pasi i larguat dokumentet nga mjediset në fillim ju është
5 dashur t'i kontrolloni dhe pastaj i keni vulosur për t'i
6 transportuar, kështu?

7 Pë. Ajo që thashë unë është kjo. U vulosën dokumentet në
8 mjedise, të themi në ndërtesën komunale. U vulosën aty, -- që
9 më bën të mendoj që qoftë kjo qese apo kuti të provave. Pastaj
10 kur i çuam në bazë ua hoqëm vulën. Punuam gjatë gjithë natës
11 për t'u bërë inventarin, hartuam procesverbalin e lëvizjen për
12 të ruajtur zinxhirin e ruajtjes, pastaj i rivulosëm për t'i
13 bërë gati për transport, për t'i çuar në Zagreb, ku janë
14 zhvulosur prapë derisa arritën në Hagë për përpunim.

15 Py. Dhe nga momenti kur ju i morët dokumentet deri në
16 momentin kur i transportuat, ju është dashur që të bëni
17 kontroll të këtyre dokumenteve apo jo?

18 Pë. Po.

19 Py. Në paragrafin 14, të raportit tuaj, ju deklaroni se:

20 "Dokumentet që janë sekuestruar, të gjitha janë sekuestruar në
21 bazë të zinxhirit të ruajtjes, COC..." më saktë.

22 Pë. Po.

23 Py. Doni të thoni që të gjitha dokumentet e sekuestruara kanë
24 marrë një vulë me klasifikimin që tregonte se çfarë zinxhiri i
25 ruajtjes që kjo të respektohej, kështu?

1 Pë. Zinxhiri i ruajtjes është proces. Nuk ka të bëjë fare me
2 vulën e vendosur, vulën e njomë d.m.th. të vulosur. Ajo ka të
3 bëjë me metadatat, që thonë që me çfarë kanë të bëjnë këto
4 dokumente, përmes zinxhirit të ruajtjes. Ne pastaj ia jepnim
5 ruajtësist të provave ose shefit të provave, njësisë së
6 provave d.m.th. dokumentacionin që tregonte zinxhirin e
7 paprishur që nga minuta kur i kemi marrë deri në minutën kur
8 kanë shkuar në Hagë. Pra, në njësinë e provave. Pastaj nuk ka
9 zinxhir - kjo tregon pra që nuk është ndërprerë zinxhiri i
10 ruajtjes.

11 Vulosja e vulës së njomë nuk tregon nëse ka apo jo
12 zinxhir të ruajtjes. Është vendndodhja që e tregon këtë gjë.
13 Pra dokumentet që janë në zinxhirin e ruajtjes kanë shkuar në
14 arkivën përkatëse e cila ishte e besuar.

15 Py. Pra, në të vërtetë, ajo që ka rëndësi është sesi
16 dokumentet janë trajtuar dhe jo sesi janë etiketuar apo
17 vulosur në momentin për të treguar që ka zinxhir të ruajtjes?

18 Pë. Jo, ne kishim dokumentacionin në rregull. Dhe bëmë dhe
19 inventarin për të parë që këto dokumente që në momentin që
20 janë marrë nga ndërtesa komunale kanë qenë në ruajtjen tonë
21 deri në momentin kur është shkuar në kazermën ushtarake kanë
22 qenë në ruajtjen tonë. Pastaj kur e kemi transportuar nga
23 kazerma në Banja Luka, në bazën tonë në Zagreb kanë qenë në
24 ruajtjen tonë dhe prandaj kemi marrë vendimin për t'i çuar me
25 automjet nga zyra e Zagrebit për në Hagë, në mënyrë që t'i

1 kishim gjithmonë nën ruajtje; për të mos pasur probleme me
2 transportin ajror dhe kështu me radhë. Çdo gjë të reflektonte
3 zinxhirin e ruajtjes.

4 Py. Pra nuk ka shumë rëndësi nëse dokumenti merr një vulë apo
5 klasifikim, nëse është në COC apo jo, pra në zinxhir të
6 ruajtjes apo jo. Pra mjafton që ju të thoshit që këto janë
7 dokumentet që janë sekuestruar, kështu?

8 Pë. Unë nuk e kuptoj plotësisht pyetjen.

9 Py. Do ta sqaroj unë. Gjatë dëshmisë së tij, pra të dëshmisë
10 së Z. Inayat, atij iu kërkua që të tregonte disa prej
11 formularëve në të cilët ju keni përshkruar provat. Dhe ai dha
12 katër shembuj të këtyre mijëra dokumenteve. Le të shohim
13 transkriptin e datës 29 janar të vitit 2002.

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Duke iu referuar dokumentit me
15 numër ERN IT-99-36, faqe T1008 deri në T1104. Faqja përkatëse
16 është faqja 1063.

17 Py. Ai i përgjigjet një pyetjeje lidhur me një prej këtyre
18 formularëve.

19 [Mungon përkthimi]

20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ka përkthim
21 tani?

22 I AKUZUARI HARADINAJ: [Përmes videolidhjes] Po, që tash
23 po.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
25 përsërisim pyetjen atëherë, nëse mundet?

1 A mund ta përsërisni pyetjen, në mënyrë që ta dëgjojë z.

2 Haradinaj?

3 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po.

4 Pyetja është kjo -- duke filluar nga citimi i faqes, z.

5 Kryetar? Pra unë do ta citoj të gjithën pyetje.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Nuk ka mikrofon].

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pra, që nga

8 rreshti 1, kur thoni "pikësëpari".

9 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Pra pyetja ishte:

10 "Pikësëpari, jo të gjitha dokumentet që janë sekuestruar

11 janë shënuar si dokumente në zinxhirin e ruajtjes, pajtoheni

12 me këtë"?

13 Përgjigjja ishte:

14 "Mund të ketë qenë kështu. Nuk më kujtohet kjo pjesë e

15 veçantë e dëshmisë së z. Inayat. Por nëse është kjo ajo që ka

16 thënë ai, pra që është shënuar që jo sipas zinxhirit të

17 ruajtjes, por siç ju thashë, të hënën e kemi përdorur në disa

18 rubrika që e kemi shënuar po ose jo. Nëse aty nuk është

19 shënuar që ka qenë në zinxhirin e ruajtjes atëherë jo nuk ka

20 qenë, nuk është trajtuar si zinxhir i ruajtjes".

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nuk e di a mjafton kjo apo jo?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: Po.

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit.

24 Py. Z. Reid, gjatë dëshmisë tuaj të datës 24 janar të vitit

25 2022, ju nënvizuat se në bazë të numrave ERN të paketave,

1 Paketa Numër 4 mori numrin e para, pastaj Paketa 2, pastaj

2 Paketa 1, kështu është?

3 Pë. Po, kështu është. Kjo duket thjesht nga numrat ERN siç i
4 kam parë.

5 Py. Po. Në bazë të numrave ERN, ju do të arrinit në
6 përfundimin që Paketa 4 kishte marrë vulën e njomë përpara
7 Paketës 2 dhe Paketa 2 kishte marrë vulën e njomë përpara
8 Paketës 1, kështu është?

9 Pë. Po.

10 Py. Nëse dokumentet janë regjistruar në prova po atë ditë,
11 kjo do të jepte një shpjegim për numrat ERN, të cilat u janë
12 vendosur paketave, kështu?

13 Pë. Po, por nuk keni marrë ndonjë informacion për këtë.

14 Py. Po do të thoshte se qeset e provave që përmbanin Paketën
15 4 janë hapur përpara dhe kanë marrë numrin përpara me vulë dhe
16 pastaj qesja e provave që përmbante Paketën 2 është hapur pas
17 kësaj dhe ka marrë numrin me vulë pas kësaj; dhe qesja e
18 provave që përmbante Paketën 1 është hapur e fundit dhe ka
19 marrë numrin me vulë e fundit, kështu?

20 Pë. Mund të jetë ky shpjegimi i mundshëm, po unë s'e kam këtë
21 informacion.

22 Py. Pra juve nuk ju është dhënë ndonjë dokument, ku
23 dokumentohet dorëzimi i qeseve të provave që përmbanin paketën
24 1, 2 dhe 4, që të jenë dorëzuar në prova në të njëjtën ditë,
25 kështu?

1 Pë. Po, e saktë.

2 Py. Dhe se qeset e provave janë hapur dhe dokumentet kanë
3 marrë numrin me vulën përkatëse duke përmbajtur kështu një
4 numër ERN, që i është caktuar dokumentit që përmbante secila
5 qese e provave. Ju nuk e keni parë këtë dokument apo jo?

6 Pë. Jo.

7 Py. Po ta kishit parë këtë dokument, mbase ju do të kishit
8 qenë në gjendje që të jepnit një shpjegim për numrin ERN, për
9 të cilat ju keni folur, kështu?

10 Pë. Po, është e saktë. Dua të them është thjesht një koment
11 që unë e kam bërë ditën e hënë që thjesht mu duk e çuditshme
12 që e kishin numrin jo sipas rendit. Thjesht ishte koment vetëm
13 kaq.

14 Py. Dëshiroj tani të kaloj tek paragrafi 23 të raportit të
15 ekspertit, të akt-ekspertizës tuaj.

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Është dokumenti që është në faqen
17 DNH0865.

18 Py. Ju sugjeroni në këtë paragraf të raportit tuaj se në çdo
19 emër dëshmitari që përfshihej në dokumentet konfidenciale,
20 ZPS-ja do të duhet të kishte identifikuar gjatë procedurës
21 statusin si dëshmitar aktiv, dëshmitar i mbrojtur, dëshmitar i
22 vdekur, dëshmitar kundërshtar, të mos quhet dëshmitar, ose i
23 pamundur të cilësohet statusi i dëshmitarit, kështu është?

24 Pë. Po, unë nuk po them që është një gjë që duhet ta bëni.

25 Unë them që është diçka që do ta kisha bërë unë dhe mu bë

1 pyetja se çfarë do të kisha bërë unë në këtë situatë dhe kjo
2 është diçka që do ta kisha bërë unë.

3 Mendoj se kjo kishte lidhje kryesisht me Paketën 1, ku
4 TFHS-ja dhe ku ZPS-ja mesa më kujtohet kishte kërkesa për
5 ndihmë dhe në shumë prej këtyre kërkesave për ndihmë kishte
6 lista të gjata dëshmitarësh. Dhe nëse unë do të kisha bërë
7 secilën prej këtyre listave do ta kisha bërë edhe këtë lloj
8 klasifikimi të dëshmitarëve.

9 Py. Sipas përvojës tuaj, gjatë kryerjes së një hetimi penal
10 konfidencial, nëse një dëshmitar i jep dëshmi apo prova
11 Prokurorisë që jo në veçanti janë të favorshme për pistën e
12 çështjes penale në fjalë, kjo nuk përbën arsye pse deklarata e
13 dëshmitarit nuk është më konfidenciale? Besoj se pajtoheni me
14 këtë?

15 Pë. Pajtohem.

16 Py. Dhe nuk do ta konsideronit deklaratën e dëshmitarit si
17 publike vetëm për faktin se dëshmitari jep gjëra që bihen
18 ndesh me ato që do Prokuroria, po?

19 Pë. E saktë është.

20 Py. Dhe në një farë mënyre nuk da konsideronit deklaratën e
21 një dëshmitari si jokonfidenciale, për shkak se Prokuroria në
22 një moment të caktuar anon nga fakti se mund mos ta thërrasë
23 këtë dëshmitar të dëshmojë. A nuk është kjo e saktë?

24 Pë. E saktë është. Por arsyeja pse unë e them këtë është se
25 unë e kuptoj se palët dhe besoj se asokohe dhe Trupi Gjykses

1 nuk do të kishte akses në asnjë pjesë të këtij dokumentacioni,
2 prandaj dhe unë e thashë që është imperative. Mbase jo
3 imperative, por unë do të merrja me radhë secilin prej këtyre
4 personave për të parë d.m.th. nëse ka një farë besimi apo jo
5 në lidhje me listat e dëshmitarëve.

6 Sepse nëse kemi 100 dëshmitarë, pesë mund të mos gjenden,
7 pesë mund të kenë vdekur, dhjetë mund të japin dëshmi të
8 kundërt me çështjen me Prokurorinë, dhjetë mund të kenë masa
9 mbrojtëse nga TPNJ-ja për shembull e kështu me radhë. Në këtë
10 pikë unë po përpiqem që këtë kam dashur të them në këtë
11 paragraf.

12 Py. Pra ju po bëni një koment mbi sasinë e informacionit që
13 sipas jush do të duhej që të nxirrej, kështu është?

14 Pë. Jo, nuk ka të bëjë me atë se çka duhet të nxirrej. Po
15 përpiqem që të them se çfarë informacioni të besueshëm do të
16 duhej që të kishim gjatë procesit të marrjes së kampionit të
17 themi.

18 Py. Juve ju është vendosur në dispozicion deklarata e
19 hetuesit që mban numrin P0090RED.

20 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Nëse kalojmë tek shtojca e kësaj
21 deklarate, ka një tabelë të dokumenteve që përmbante Paketa 1,
22 e cila përshkruhet. Në veçanti dëshiroj që të kalojmë tek
23 faqja 095537.

24 Py. Siç e shihni në shtyllën e fundit në të djathtë thotë:
25 "Emri ose emrat e dëshmitarëve të mundshëm (po/jo)". Dhe ky

1 informacion jepet për çdo dokument, faqe për faqe. E shihni
2 këtë?

3 Pë. A mund ta zmadhoni dhe pak ju lutem se nuk e shoh mirë?
4 Thotë 37. E kam një kopje të kësaj.

5 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A mund ta
6 përsërisni dhe njëherë?

7 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Pra po thoja që shikoni që tek
8 kolona e fundit e tabelës thuhet n.q.s. kemi dëshmitarë të
9 mundshëm apo jo. Dhe kjo në fakt është reflektuar në çdo faqe
10 të mundshme të dokumentit që është pjesë e Paketës numër 1. A
11 e shikoni këtë ju lutem?

12 Pë. Po, e shoh.

13 Py. Tani n.q.s. do të shkojmë në dokumentin 095533, nëse do
14 t'i referoheni paragrafit 3 të deklaratës ju lutem, atëherë
15 këtu thuhet që tabela përfshin nëntë kolona, gjashtë prej të
16 cilave kërkon informacion sa i takon nxjerrjes së dokumenteve
17 të caktuara, të cilat janë nxjerrë nga OVL-ja e UÇK-së. Dhe po
18 ashtu përmendet edhe vendimi i Panelit sa i takon nxjerrjes së
19 këtyre dokumenteve.

20 A e kuptoni se fusha e veprimit sa i takon dokumenteve
21 konfidenciale që i janë dhënë të akuzuarit është përcaktuar
22 përmes një vendimi gjyqësor. A e keni marrë këtë informacion
23 gjatë rishikimit të dokumenteve.

24 Pë. Po, e kam marrë. E kam marrë këtë informacion.

25 Py. Pra opinioni jua j ka të bëjë me sasinë e informacionit që

1 duhej të nxirret dhe nuk komenton mbi praktikat e ZPS-së, a
2 është e saktë kjo?

3 Pë. Thjesht unë kam dhënë një koment lidhur me atë çfarë do
4 të kisha bërë unë. Dhe siç e thashë dhe më parë, n.q.s. do të
5 kisha 100 dëshmitarë të ndryshëm në shtojcat, kur të ishte e
6 mundur, unë në fakt do të kaloja secilin prej këtyre njëri pas
7 tjetrit dhe do të përcaktoja se cili ishte klasifikimi i tyre.
8 Py. Pra, pajtoheni me mua se të gjithë dëshmitarët, të cilët
9 i japin prova Prokurorisë kanë të njëjtin nivel mbrojtjeje,
10 pavarësisht vlerësimit të cilësisë së provave apo të dhënave
11 që japin ata. A jeni dakord me mua?

12 Pë. Po, dakord jam.

13 Py. Në paragrafin 23 të raportit që keni shkruar, ju thoni se
14 dëshmitarët e vdekur duhet të ishin të identifikuar si të
15 tillë. A keni identifikuar, a keni verifikuar n.q.s. ZPS-ja ka
16 marrë një qasje të tillë konservatore dhe nuk e ka marrë
17 parasysh, le të themi këtë çështje për të parë n.q.s. emrat e
18 dëshmitarëve janë përfshirë ose nuk janë përfshirë në
19 dokumente të caktuara të Paketës Numër 1.

20 Pë. N.q.s. e kuptova pyetjen tuaj, siç e thashë dhe më parë,
21 dëshmitarët e vdekur duhet të mbrohen gjithashtu dhe sepse në
22 qoftë se një dëshmitar ka vdekur nuk do të thotë se ata nuk
23 gëzojnë mbrojtje.

24 Py. Pra n.q.s. ZPS-ja në një qasje konservative, në qasjen
25 *pro reo* do kishte vendosur që të mos i shqyrtonte fare sot, të

1 mos i merrte fare parasysh emrat e dëshmitarëve të vdekur, të
2 dëshmitarëve, emri konfidencial i të cilëve dukej ose shfaqej
3 në dokumente të caktuara ose n.q.s. nuk do të kishte marrë
4 parasysh të shqyrtonte ose të reflektonte persona, të cilët
5 kishin refuzuar bashkëpunimin me ZPS-në. Ju e konsideroni këtë
6 një qasje konservatore lidhur me numrin e emrave të
7 dëshmitarëve ose n.q.s. emrat e dëshmitarëve do të ishin
8 përfshirë në dokumente apo jo. Pajtoheni me mua?

9 Pë. Nuk e kuptoj pyetjen plotësisht. Ajo çfarë po them unë
10 këtu është që n.q.s. ti mund ta klasifikosh një dëshmitar të
11 caktuar, një kategori të caktuar mendoj që ky është një proces
12 i rëndësishëm. Dhe kjo është e vetmja gjë që doja të thoja. Ky
13 është i vetmi koment që kam bërë dhe ky koment është bërë në
14 kuadrin, në kornizën që palët dhe Trupi i Gjyimit dhe nuk e
15 di n.q.s. jam i saktë apo jo këtu, pra e merrte
16 dokumentacionin apo jo.

17 Pra me fjalë të tjera, po të isha unë në vendin tuaj do
18 të jepja sa më shumë informacion që të ishte e mundur.

19 Py. Po, por mendimi juaj është që edhe një person ose një
20 dëshmitar që ka vdekur edhe ky duhet të jetë subjekti i
21 konfidencialitetit gjatë hetimeve konfidenciale hetimore
22 kriminale. E kam të drejtë, është kështu?

23 Pë. Po. Dëshmitari i vdekur duhet t'a marrë këtë mbrojtje por
24 ajo që është më e rëndësishme d.m.th. mbrojtja duhet t'i
25 ofrohet anëtarëve të familjes së dëshmitarëve që kanë vdekur.

1 Pë. Faleminderit. Z. Reid, dua t'ju tregoj një dokument.

2 Dokumenti i cili ka numrin e identifikuar si P00092RED. Ky

3 është një Njoftim Zyrtar sa i takon sekuestrimit të

4 dokumenteve me datë 8 shtator 2020. A ju është treguar ky

5 dokument përpara sesa të shkruanit raportin tuaj, për t'ju

6 përgatitur për të shkruarin e raportit tuaj?

7 Pë. Jo.

8 Py. Dua t'ju sjell në vëmendje një paragraf, që është

9 paragrafi 12 i këtij dokumenti që ka të bëjë me vendosjen e

10 dokumenteve në dy qese provash. A jeni dakord me mua se në

11 mënyrë që të jesh në gjendje të japësh një vlerësim për

12 çështje që kanë të bëjnë me zinxhirin e ruajtjes do të kishte

13 qenë mirë për ju që të shikonit dokumente të tilla, si puna e

14 këtij dokumenti, në mënyrë që juve të jepnit mendimin tuaj

15 pasi të ishit informuar plotësisht?

16 Pë. Ju kërkoj ndjesë. Po lexoja paragrafin dhe nuk e kapa

17 pyetjen tuaj. Atëherë mendoj që e kam printuar në fakt nga

18 dokumentet që kam marrë sot në mëngjes. Po, e kam të printuar

19 dokumentin të cilit i referoheni. Po, e lexova, e lexova

20 paragrafin 12.

21 Py. Informacioni i ngjashëm me informacionin që jepet në këtë

22 dokument, a do ju kishte vyer juve në mënyrë që të kishit bërë

23 një vlerësim pasi të ishit informuar sa i takon procedurave të

24 cilat që ka bërë ZPS-ja dhe n.q.s. ajo ka qenë në përputhje me

25 praktikat më të mira apo jo?

1 Pë. Jam dakord. Por nuk e kuptoj nga ky dokument, n.q.s. këto
2 dokumente janë dorëzuar në OVL-në e UÇK-së apo në ZPS, sepse
3 duket sikur janë dërguar në zyrën tuaj atje.

4 Py. Z. Reid, pyetja është kjo. Dokumentet, të cilat
5 përshkruajnë sekuestrimin e dokumenteve, një dokument i tillë
6 i kësaj natyre a do të kishte qenë i rëndësishëm për juve
7 ndërkohë që ju kundërshtonit praktikën e ZPS-së, d.m.th. për
8 të pasur raportin tuaj ekspert sa i takon praktikës së ZPS-së.
9 Një dokument i tillë a do t'ju kishte qenë i dobishëm për
10 juve?

11 Pë. Po, i gjithë dokumenti do të kishte qenë i dobishëm.

12 Py. Por ju nuk është se e keni pasur në dispozicion këtë
13 dokument?

14 Pë. Jo.

15 Py. Nuk keni pyetur, nuk keni kërkuar që ta keni këtë
16 dokument

17 Pë. Unë nuk e dija që ekzistonte.

18 Py. Tani më lejoni t'ju tregoj një tjetër dokument. Dokumenti
19 i cili identifikohet me P0099RED. Nëse e shikoni këtë
20 dokument, ky është një dokument i cili konfirmon marrjen e
21 dokumenteve që janë pjesë e Paketës 4. Nëse do shikoni
22 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 në faqen 083987, pra nëse do
23 shikoni informacionin që jepet këtu, a pajtoheni me mua që ky
24 është lloji i informacionit që duhet të analizoni në mënyrë që
25 të jeni në gjendje të vërtetoni n.q.s. procedurat e caktuara

1 janë ndjekur ose jo nga ZPS-ja?

2 Pë. Ky është një tjetër dokument, që do kishte qenë i
3 dobishëm. Megjithatë, siç e kam thënë dhe në raportin tim, unë
4 jo domosdoshmërisht mendoj se Paketa 4 është pjesë e zinxhirit
5 të ruajtjes. Pra ky është një dokument, i cili ka të bëjë me
6 dorëzimin e dokumenteve të sekuestruara, d.m.th. nuk është një
7 dokument që flet për një urdhër apo një dokument që ka të bëjë
8 me kontrollin dhe me sekuestrimin. Megjithatë, do të kishte
9 qenë i dobishëm n.q.s. do ta kisha pasur në dispozicion.

10 Py. Pra ky është një dokument, i cili do ndihmonte për të
11 vërtetuar n.q.s. janë ndjekur procedura të nevojshme nga ZPS-
12 ja apo jo?

13 Pë. Po, pa diskutim, do të kishte qenë mirë të kisha pasur më
14 shumë informacion.

15 Py. Dhe ju nuk e keni pasur këtë informacion?

16 Pë. Jo.

17 Py. Pra kur ju keni hartuar raportin tuaj të ekspertit, ju
18 nuk keni pasur të gjithë informacionin e nevojshëm për të
19 vërtetuar n.q.s. të gjitha procedurat e ZPS-së janë respektuar
20 apo jo?

21 Pë. Unë thashë që çfarëdo dokumentesh kam pasur në
22 dispozicion. Nuk kam pasur as deklaratat e hetuesve të
23 procedurës.

24 Py. D.m.th. në momentin kur juve iu kërkua që të bënit
25 vlerësimin e ekspertit juve nuk është se ju është vënë në

1 dispozicion ndonjë dokument që vërteton se cila kishte qenë
2 procedura e ndjekur nga ZPS-ja?

3 Pë. Unë nuk thashë që ZPS-ja nuk ka ndjekur procedurën e
4 rregullt. Ajo çfarë thashë unë është që po të kisha qenë unë
5 në vendin tuaj do kisha ndjekur një procedurë të caktuar,
6 d.m.th. ky është vlerësimi im.

7 Py. Po, në rregull. Dhe kur keni dhënë komentin tuaj se çfarë
8 pamje kishin procedurat e ZPS-së ose si me thënë cilat ishin
9 procedurat e bëra nga ZPS-ja, ju nuk është se keni pasur të
10 gjithë informacionin e nevojshëm në mënyrë që të vërtetonit
11 apo të vlerësonit n.q.s. procedura do të kishte qenë e
12 rregullt apo jo?

13 Pë. Unë kam pasur transkriptet publike që më dhanë një ide
14 n.q.s. do kisha lexuar për shembull transkriptin e hetuesit,
15 kur ajo solli për shembull në 25 shtator, kam përshtypjen që
16 ishte data, që ka sjellë disa dokumente, i ka sjellë mbrapsht.
17 Do të kishte qenë mirë se do e kisha kuptuar se si ishte bërë
18 mbledhja e informacionit dhe sesi ishte sjellë qesja me
19 dokumente mbrapsht.

20 Py. Por Avokati i Mbrojtjes nuk jua vuri në dispozicion
21 dokumentet që ato kishin, e saktë është kjo?

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

23 Z. CADMAN: [Përkthim] Kundërshtoj të nderuar Gjykatës. Z.

24 Reid ka marrë çdo gjë, çdo dokument që ne kemi pasur mundësi
25 që t'i japim në atë kohë. Sugjerimi që dokumentet nuk janë

1 dhënë në dispozicion atij nuk qëndron sepse këto dokumente nuk
2 kanë ekzistuar në momentin kur ai është zgjedhur si ekspert.

3 Besoj që ju, të nderuar Gjykatës e mbani mend edhe në
4 komunikimet *inter partes* dhe çfarë kemi thënë ne atëherë. Dhe
5 ZPS-ja ka refuzuar që të përfshihej në këtë ushtrim në atë
6 kohë. Kështu që ne i kemi dhënë ato dokumente që kemi pasur të
7 disponueshme në atë kohë, si për shembull transkriptin. Dhe
8 kjo është baza me të cilën i kemi dhënë dokumentet z. Reid.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
10 Rrëzohet kundërshtimi.

11 Znj. Bolici.

12 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Lidhur me atë çfarë tha, sapo tha
13 z. Cadman, dëshiroj të them që ZPS-ja nuk ka përcaktuar
14 asnjëherë se çfarë dokumentesh duhet t'i japë ose mos t'i japë
15 z. Cadman ekspertit të vet.

16 Py. Gjithsesi z. Reid, d.m.th. për ta përmbyllur këtë pjesë,
17 juve nuk jua dhënë dokumente, të cilat bëjnë të mundur

18 vlerësimin e procedurave që janë ndjekur nga ZPS-ja apo jo?

19 Pë. Siç e thashë, një pjesë e dokumentacionit më ka ndihmuar
20 mua për të vlerësuar ose më ka ndihmuar mua pjesërisht.

21 Ndërkohë që dokumentet që juve sapo më treguat nuk më janë
22 vënë në dispozicion.

23 Py. Faleminderit.

24 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar
25 Gjykatës. Nuk kam pyetje të tjera.

1

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në rregull.

3 Z. Cadman, keni ndonjë pyetje plotësuese për dëshmitarin?

4 Z. CADMAN: [Përkthim] N.q.s. është e mundur, do të doja
5 të më jepnit pesë minuta për ta menduar pak.

6 [Prokurorët e Specializuar këshillohen]

7 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman.

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, nuk kam
10 pyetje. Por ajo çfarë do të doja të thoja është që dua të
11 falënderoj z. Reid dhe dua ta përgëzoj sepse ai sapo ka marrë
12 një urdhër domethënës për Australinë, që është Urdhri për
13 Shërbimin në Hetimet Ndërkombëtare Penale. Besoj që e keni
14 dëgjuar këtë. Thjesht do të doja ta sillja në vëmendjen tuaj.15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
16 z. Cadman. E kemi lexuar këtë gjë dhe pa diskutim që
17 reputacioni i z. Reid është shumë i mirë.18 DËSHMITARI: [Përkthim] Faleminderit, të nderuar Gjykatës.
19 Faleminderit, z. Cadman.20 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit
21 ju z. Cadman.

22 Znj. Bolici.

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Dua që të kërkoj pranimin në
24 prova të disa prej dokumenteve të cilat janë dëshmuar prej
25 dëshmitarit ekspert dhe në veçanti dua të kërkoj regjistrimin

1 në prova të videos me numër identifikimi ERN 1047290 [sipas
2 përkthimit] dhe transkriptin përkatës, siç është përmendur në
3 dëshminë e dëshmitarit si provues edhe si të rëndësishëm.

4 Dhe po ashtu sa i takon udhëzimeve që u dhanë nga Trupi
5 Gjykses sot, kërkoj që të pranohet vendimi publik i gjykimit
6 në TPNJ dhe ky është dokumenti IT-04-84 [sipas përkthimit], i
7 prillit 2008. Është vendimi për gjykimin në çështjen Haradinaj
8 dhe të tjerët (*et al*) dhe gjithashtu një kopje në PDF të
9 vendimit t'i vihet në dispozicion palëve, po gjithashtu edhe
10 Zyrës së Administrimit përpara sesa të fillonte marrja në
11 pyetje.

12 Edhe së fundi, dua që të kërkoj pranimin në prova të
13 dokumenteve, të cilat janë shqyrtuar sot me dëshmitarin. E kam
14 fjalën për dokumentet IT-99-36, T-1008 deri në T-1034 [sipas
15 përkthimit], dhe dokumentet e tjerë, të cilët pra i diskutuam
16 dhe i shqyrtuam sot.

17 Të gjitha këto materiale janë materiale publike.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman
19 doni të flisni?

20 Z. CADMAN: [Përkthim] Vazhdojmë që të kemi të njëjtin
21 pozicion sa i takon asaj çfarë shprehëm të hënën, d.m.th. jemi
22 kundër pranimin të dokumenteve, të cilët kanë të bëjnë thjesht
23 me kuadrin, me kornizën historike dhe nuk është se kanë të
24 bëjnë specifikisht me këtë gjykim.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Z. Bowden.

2 Z. BOWDEN: [Përkthim] Mbështes z. Cadman.

3 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykata do
4 vendosë më vonë sa i takon pranimit të dokumenteve.

5 Z. Rees, ju kërkoj ndjesë. Nuk kisha ndërmend që t'ju
6 anashkaloja.

7 DËSHMITARI: [Përmes videolidhjes] [Përkthim] Jo, nuk
8 është se kisha ndonjë gjë që të thoja.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Jo, thashë z.
10 Rees, jo z. Reid.

11 Ju lutem ndizeni mikrofonin kur të flisni z. Rees.

12 Dëgjoni gjë?

13 Nuk e di a mund t'i shkruani njëri-tjetrit, mund t'i
14 dërgoni tekst, mesazh në tekst z. Bowden?

15 Z. BOWDEN: [Përkthim] Po, mund ta bëj këtë gjë.

16 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mbase mund të
17 na thoni ju se çfarë do të thotë z. Rees sepse nuk e dëgjojmë
18 z. Rees.

19 Z. BOWDEN: [Përkthim] N.q.s. nuk na lejon teknologjia,
20 mund të mundohem unë ta bëj këtë gjë.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Mund ta
22 presim për një çast.

23 Z. Cadman, ke ndonjë gjë për të thënë?

24 Z. CADMAN: [Përkthim] Po. Unë nuk kam kërkuar zyrtarisht
25 për deklaratën e z. Reid që të regjistrohej si provë dhe

1 sigurisht d.m.th. kjo do jetë prova e fundit shtesë që ne
2 kërkojmë për t'u pranuar në listën e dokumenteve si dhe
3 manuali i TPNJ-së.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Si pjesë e
5 këtyre dokumenteve, do vendosim pak më pas.

6 Z. Cadman, le të presim pak edhe t'i japin mundësinë z.
7 Rees që të shprehet n.q.s. e lejon teknologjia.

8 [Anëtarët e Trupit Gjykses këshillohen]

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rees, më
10 thanë që do të ishte mirë që të dilnit nga sistemi dhe të
11 regjistroheshit edhe njëherë, nëse është e mundur.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Nuk e di nëse mund të konsultohem
13 pak me z. Haradinaj për një çështje, ndërkohë që presim z.
14 Rees.

15 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Nuk e di nëse
16 më dëgjoni tani.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju dëgjojmë.
18 Në qoftë se është e mundur, ngrijeni pak zërin, volumin.

19 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Do kërkoja edhe
20 ndihmë nga Sekretarja që të ngrihet ndoshta volumi në sallën e
21 gjyqit.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Tani të
23 dëgjojmë mirë.

24 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

25 Atëherë, sa i takon pranimit të propozuar të dokumenteve

1 që kërkoi znj. Bolici.

2 Unë parashtroj që këto dokumente nuk duhen që të pranohen
3 asnjë prej tyre, sepse ai ka dhënë përmes provave të veta
4 përgjigjet ndaj pyetjeve.

5 Ndërkohe që sa i takon këtyre dokumenteve të cilat janë
6 paraqitur nga ZPS-ja, ai nuk ka pasur njohuri për to dhe këto
7 dokumente nuk kanë të bëjnë fare me vlerësimin e tij prej
8 eksperti.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
10 Do ta marrim parasysh edhe këtë kontribut tuajin në momentin
11 kur të vendosim për pranimin e dokumenteve, ose sot me vonë,
12 ose të hënën.

13 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne kemi disa
15 pyetje nga anëtarët e Trupit Gjykses. Do fillojmë me
16 Gjykatësin Mettraux.

17 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit Gjykatësi
18 Smith dhe mirëmëngjesi z. Reid.

19 Pyetje nga Trupi Gjykses:

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dua të bëj disa pyetje të
21 cilat ju bënë juve të hënën. Ndërkohë, juve ju bënë disa
22 pyetje sa i takon intervistës që ju keni dhënë dhe sa i takon
23 frymës së përgjithshme të kërcënimit që ekziston në Kosovë sa
24 i takon dëshmitarëve. A i mbani mend këto pyetje?

25 Pë. Po, i mbaj mend.

1 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni në
2 qoftë se kjo klimë ose ky mjedis frikësimi të cilën juve e
3 përshkruat në intervistën tuaj, ka ndikuar në punën tuaj në
4 zyrën e Prokurorisë, në veçanti sa i takon aftësisë për të
5 hetuar dhe për të ndjekur penalisht?

6 Pë. Të nderuar Gjykatës, sa i takon hetimit në vetvete, ne
7 kemi qenë në gjendje që të mbronim informacionin deri në kohën
8 kur janë ngritur aktakuzat. Në atë fazë mendoj që Prokurorët
9 në të tri çështjet që ne kemi pasur, atëherë kemi filluar që
10 të kemi probleme, kur gjërat u bënë publike.

11 Dhe siç e thashë, dëshmitarët refuzonin që të jepnin më
12 prova. Dhe dhashë një shembull të një dëshmitari që erdhi në
13 gjykatë në Hagë, ishte në bankën e dëshmitarit dhe refuzoi të
14 fliste dhe pavarësisht që gjyqtari i tha që, në qoftë se nuk
15 do të jepte dëshmi mund të shkonte në burg dhe ai prapëseprapë
16 vendosi që të mos fliste.

17 Pra, ishte një situatë shumë e vështirë. Çështjet e
18 Kosovës, apo të gjitha çështjet e ish-Jugosllavisë ishin shumë
19 të vështira, por në veçanti lëndët që kishin të bënin me
20 Kosovën.

21 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Mendoj se sapo thatë tri
22 çështje. A mbani mend se për çfarë çështjesh e keni fjalën?

23 Pë. Po. Çështja e parë ishte çështja Limaj, e dyta ishte
24 Haradinaj dhe pastaj ishte ri-gjykimi për Haradinaj. Dhe ne
25 kemi pasur probleme në të tria këto çështje sa i takon

1 prokurorisë. Nuk është kritikë kjo për prokurorinë, por
2 thjesht për t'ju thënë që ishte vërtetë shumë e vështirë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Në një mjedis të tillë,
4 dhe sërish sipas mendimit dhe përvojës tuaj, sa dëmtuese do të
5 ishte rrjedhja e informacionit sa i takon aftësisë tuaj për të
6 përmbushur mandatin tuaj si prokuror, për shembull?
7 Pë. Do të ishte shumë e vështirë. Dhe sigurisht ne kemi pasur
8 procedura të miratuara. Tani, nuk është se i mbaj mend të
9 gjitha, megjithatë kam përshtypjen që arritëm deri në një pikë
10 kur kishim procedurat e evakuimit me KFOR-in me forcat
11 ushtarake për evakuimin e dëshmitarëve dhe familjarët e tyre
12 të menjëhershëm nga Kosova, në mënyrë që të mund t'i ofronim
13 një mjedis më të sigurt.

14 Vështirësia me Kosovën është që, në disa raste për
15 shembull në qoftë se ti, le ta zëmë që punon në Australi,
16 familja e ngushtë janë 3-4 veta, persona që do të duhen të
17 ekstradohen ose të mbrohen. Por, në Kosovë familjet ishin
18 shumë të mëdha, mund të ishin 50-60 vetë të cilët jetonin me
19 njëri-tjetrin në një kompleks. Kështu që në këtë rast ishte
20 shumë herë më e vështirë që të bëhej ushtrimi i lëvizjes së
21 njerëzve. Me aq sa kujtoj unë tani, e kemi përdor vetëm një
22 herë këtë procedurë, d.m.th. evakuimin e një familje të tërë
23 që lidhej me një dëshmitar.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ndoshta pyetja ime është
25 pak sa hipotetike z. Reid, por në një situatë të tillë

1 hipotetike, sa i shqetësuar do të ishit juve në qoftë se
2 informacioni i mbrojtur, sa i takon dëshmitarit tuaj, do të
3 rridhte? Pra, sa i shqetësuar do të ishit ju si prokuror në
4 qoftë se do të bëhej publik informacioni që do të lidhej me
5 dëshmitarin tuaj?

6 Pë. Do isha shumë i shqetësuar.

7 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A mund të na thoni pse do
8 të ishit i shqetësuar?

9 Pë. Rrjedhja e çfarëdolloj informacioni e cenon shumë
10 çështjen e prokurorisë. Rrjedhja e informacionit që ka të bëjë
11 me dëshmitarët, është dyfish më e rëndë, sepse ka ndikim mbi
12 psikologjinë e dëshmitarit X dhe të komunitetit të
13 përgjithshëm të dëshmitarëve. Në qoftë se e merr vesh
14 komuniteti tjetër i dëshmitarëve, mund të ketë ndikim mbi ta
15 po ashtu. I takon që do të kishte një efekt më të
16 përgjithshëm.

17 Për shembull, në qoftë se informacioni për një dëshmitar
18 të caktuar del, kjo dalje e informacionit mund të ketë ndikim
19 mbi 15-20 dëshmitarë të ndryshëm.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Z. Reid, po ju pyes për
21 diçka tjetër. Dhe nuk dua të jepni informacione konfidenciale
22 dhe prandaj i përmbajmë të përgjithshme. Zyra e Prokurorit të
23 TPNJ-së, a ka bashkëpunuar me Serbinë për hetimin e disa prej
24 çështjeve tuaja?

25 Pë. Po. Për çështje të cilat i përmenda, po, ne kemi

1 bashkëpunuar me Republikën e Serbisë. Kemi bashkëpunuar me
2 Republikën e Serbisë për shumë gjëra, për çështjet e Kosovës e
3 kështu me radhë.

4 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] A keni kërkuar dhe keni
5 marrë informacion nga Republika e Serbisë si pjesë e këtij
6 bashkëpunimi?

7 Pë. Dokumentet që ne kërkonim ishin dëshmia e ndërlihdjeve që
8 vinte nga autoritetet dhe ato kishin informacione të mëdha
9 lidhur me krijimet në terren. Kishin informacion lidhur me
10 dëshmitarë të posaçëm. Por informacioni që kishim nevojë ne
11 ishin ndërlihdjet, për shembull shërbimi i zbulimit ushtarak i
12 tyre, çfarë kanë gjetur forcat serbe lidhur me forcat kosovare
13 në terren, kush ishin komandantët e kështu me radhë.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju kërkoj ndjesë që po ju
15 bëj pyetje që mund ta ketë përgjigjen të qartë z. Reid, por
16 gjatë këtij bashkëpunimi, a i keni zgjedhur vetë ju personat
17 me të cilët keni bashkëpunuar, apo autoritetet ju kanë treguar
18 se me ke të bashkëpunoni?

19 Pë. Në disa raste autoritetet e kanë caktuar. Por nga ana
20 tjetër kemi pasur marrëdhënie të mira bashkëpunimi me një
21 numër autoritetesh që nga ajo kohë, kështu kemi biseduar edhe
22 me to dhe ato na kanë siguruar në fakt informacionin që na
23 duhej.

24 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe në këtë kontekst, a
25 keni bashkëpunuar me z. Vukçeviq dhe zëvendësit e tij?

1 Pë. Z. Vukçoviq ishte hetues i krimeve të luftës dhe jemi
2 marrë me të shumë, shumë herë për shumë çështje në Kosovë.

3 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe a keni menduar si
4 rezultat i bashkëpunimit me autoritetet zyrtare serb të jetë
5 kompromentuar në fakt hetimi juaj, apo pavarësia hetimore?

6 Pë. Jo, nuk do të thoja që ishte kompromentuar. Z. Vukçeviq
7 ka bërë të pamundurën për të na ndihmuar. Në disa raste e kanë
8 penguar autoritetet në prapaskenë, qeveria e tij. Hetimet janë
9 kompromentuar për shkak të frikës dhe kanosjes që ka ekzistuar
10 lidhur me këto hetime dhe procedime penale.

11 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Informacioni që keni marrë
12 nga serbët mund të jetë i tillë, por në përgjithësi si një
13 oficer policie me përvojë dhe hetues, kur merrni informacione
14 nga një burim i caktuar, a e merrni si të qenë, apo e
15 verifikoni më tej dhe kërkon që ta provoni atë përpara se të
16 vendosni për ta përdorur si provë apo jo? Kështu është?

17 Pë. Po. Gjithmonë kërkohet që të bëhet një verifikim edhe në
18 qoftë se bëhet fjalë për një dëshmitar të një krimi të
19 veçantë, apo për disa ndërlidhje midis një hetuesi, një
20 dëshmitari të nivelit të lartë, e kështu me radhë. Gjithmonë
21 përpiqesh që ta bësh këtë. Sa herë që të jetë e mundur, duhet
22 kërkuar që të bëhet verifikimi i dëshmisë së çdo dëshmitari.

23 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Dhe përsëri, nga praktika
24 juaj në Australi apo në TPNJ, a ka ndodhur që të keni marrë
25 informacion nga individë të cilët ju keni dyshuar se vetë kanë

1 bërë krime?

2 Pë. Po. Në disa raste edhe në fakt kjo ka qenë një nga
3 vështirësitë me të cilat jemi përballur, pra në disa raste ne
4 kemi hetuar një keqbërës dhe pastaj na ka dalë një grup
5 viktimash. Nga ana tjetër kemi hetuar viktima të cilët ishin
6 pjesë e grupit keqbërës, të aktorëve të krimit, E kupton?

7 Këto janë problemet dhe kjo ka ndodhur nja dy herë. Në
8 fakt disa herë. Në rastin kur vetë aktorët e krimit kanë dhënë
9 dëshmi apo informacion. Ne pastaj kemi bërë verifikimin e
10 kësaj dëshmie të dhënë për të parë nëse është e vërtetë.

11 Ka disa raste kur të akuzuarit të cilët e kanë pranuar
12 krimin, japin dëshmi për eprorët e tyre. Dhe pastaj bëhet
13 verifikimi i dëshmisë së tyre.

14 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Ju i jeni përgjigjur
15 pyetjes sime. Pra në rastet kur keni marrë informacion nga
16 dikush për kryerjen e një krimi, ju do të merrni hapat e
17 duhura për të bërë si hetues dhe prokuror për të verifikuar
18 vërtetësinë e këtij informacioni. A është kështu?

19 Pë. Po.

20 GJYKATËSI METTRAUX: [Përkthim] Faleminderit z. Ried.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Gjykatësi
22 Gaynor ka disa pyetje.

23 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Z. Reid, kam nja dy pyetje
24 që kanë të bëjnë me procedurat standarde operative apo
25 udhëzuese të OSPG, siç e thatë ju me shkurtesën tuaj. Kjo

1 është në paragrafin 9 të raportit tuaj:

2 "Janë këto udhëzime të cilat janë hartuar në javët e para
3 të TPNJ-se dhe siç ka evoluar situata dhe janë zhvilluar
4 punimet në zyrë, të gjithë këto udhëzues dhe procedura kanë
5 evoluar dhe ato janë zhvilluar më tej"

6 Dhe ju i keni treguar këto në paragrafin 10 të raportit
7 tuaj.

8 A mund ta sqaroni se, kur mendoni ju që të ketë hyrë në
9 fuqi ky udhëzues, SOPG-ja pra?

10 Pë. Ka hyrë në fuqi në momentin që zëvendësprokurori e ka
11 miratuar këtë. Disa nga procedurat operative standarde i kemi
12 zbatuar, për shembull mbi misionet, sa herë që shkonim me
13 mision nga shtatori apo tetori i 1994, pra në atë kohë ne i
14 kemi zbatuar këto procedura gjatë misioneve, mënyrën se si të
15 bëhet një mision, cilat janë raportimi, kushtet për të
16 raportuar.

17 Këto procedura standarde, të tjera për shembull që kanë
18 të bëjnë me kontrollin, me konfiskimin. Për shembull kur
19 shkua në Prijedor, ne kemi pasur edhe urdhrin e kontrollit
20 dhe ne e kemi pasur këtë që në shkurt të 1996, pra që nga
21 fillimi i shkurtit të 1996. Nuk mund të jap një datë të saktë,
22 ato kanë evoluar, por i kemi zbatuar këto sa herë që kemi
23 pasur nevojë.

24 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Në paragrafin 12 ju thatë
25 që:

1 "Punonjësit janë të detyruar të dinë jo vetëm për
2 ekzistencën e SOPG, por është po aq e rëndësishme të kuptojnë
3 edhe përmbajtjen e tyre dhe zbatimin e tyre".

4 Dhe më pas ju bëni dallimin midis para periudhës së 2000
5 dhe më pas.

6 Po të shikojmë periudhën deri në 2000 dhe ju jemi larguar
7 në vitin 2018, çfarë mekanizmash ka pasur për t'i shpërndarë
8 këto udhëzues për të tërë punonjësit?

9 Pë. Para vitit 2000 i kemi bërë një nga një. Më pas e kemi
10 bërë -- ky ka qenë një libër, një doracak i cili i është dhënë
11 të gjithë punonjësve të rinj. Punonjësit e rinj janë kombinuar
12 me punonjës më me përvojë për shkak se ne mbas vitit 2000 kemi
13 pasur një numër çështjesh penale dhe kështu që ato kanë
14 bashkëpunuar me prokurorë dhe hetues me më shumë përvojë. Po
15 kështu kemi pasur edhe një formular të fillimit të punës, që
16 mund ta quaj, ku anëtarëve i është dhënë ky informacioni me
17 anë të kësaj broshure.

18 Më kujtohet për shembull, një nga avokatët më të lartë
19 Mundis dhe të dy bashkë me Vladimir Tochilovsky, nëse është i
20 saktë emri, kanë hartuar këto dokumente për të tërë punonjësit
21 e tjerë.

22 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] A mund të thoni që ka pasur
23 mekanizëm për të bërë të mundur që punonjësit e Zyrës së
24 Prokurorisë t'i zbatojnë këto udhëzime?

25 Pë. Zbatimi formal është bërë përmes vëzhgimeve të avokatëve

1 të lartë apo udhëheqësve të ekipit të veçantë. Në disa raste
2 më kanë treguar edhe mua, por në përgjithësi shumica dhe e kam
3 fjalën për mbi 90 për qind, i kanë zbatuar vetëm
4 procedurat.

5 GJYKATËSI GAYNOR: [Përkthim] Dakord. Faleminderit z.
6 Reid.
7 Pë. Faleminderit.

8 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Reid, këtu
9 përfundon dëshmia juaj. E vlerësojmë kohën që na keni dhënë në
10 këto dy ditët e fundit dhe ju urojnë që të keni një mbrëmje sa
11 më të këndshme.

12 DËSHMITARI: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Faleminderit
13 të nderuar Gjykatës.

14 [Dëshmitari largohet nga videolidhja]

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Para se të
16 marr pushimin, po trajtojmë çështjen e raportit të z. Reid të
17 cilin e ka paraqitur z. Cadman.

18 Znj. Bolici, ju kundërshtoni paragrafin 26, fjalinë e
19 dytë të 27, tërë paragrafin 28, fjalinë fundit dhe frazën "në
20 përputhje me rregulloren e proceduarave" në paragrafin 30 dhe
21 frazën "në përputhje me RPE" në paragrafin 31. A ka ndonjë gjë
22 tjetër?

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo, kaq kisha.

24 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Cadman, a
25 keni ndonjë gjë për të shtuar? E kemi diskutuar këtë çështje

1 më parë.

2 Z. CADMAN: [Përkthim] Qëndrimi ynë është që, i tërë
3 raporti do të duhet të pranohet. Ai ka dhënë dëshmime të tëra.
4 Prokuroria ka pasur mundësinë për t'i bërë pyetje. Dhe ne
5 mendojmë që të gjitha këto pjesë janë me vlerë dhe nuk duhen
6 të fshihen.

7 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Bowden?

8 Z. BOWDEN: [Përkthim] Nuk kam komente.

9 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Pasi ka
10 dëgjuar palët, Paneli e pranon raportin e ekspertit përveç
11 paragrafit 26, fjalinë e fundit të paragrafit 27, paragrafët
12 28 dhe 30, dhe frazën "në përputhje me RPE, me rregullat e
13 procedurës" në paragrafin 31.

14 Trupi Gjykses vëren që, këto paragrafë kanë opinione të
15 papranueshme lidhur me faktin nëse procedurat e kontrollit dhe
16 të konfiskimit të ZPS janë në përputhje me rregulloren. Përveç
17 kësaj paragrafi 30 ka komente të cilat nuk kanë të bëjnë me
18 tematikën.

19 Duke pasur parasysh faktin që akt-ekspertiza është e
20 tillë, Trupi Gjykses i kërkon Mbrojtësit të Haradinajt që
21 brenda 31 janarit 2022 të paraqesë një dokument të redaktuar
22 duke hequr pjesët e fshira këtu.

23 Znj. Sekretare, mund të jepni numër prove materiale.

24 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Do të ketë numrin 2D12.

25 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

1 Pranohet.

2 Dhe për sa i përket klasifikim Z. Cadman, a keni ndonjë
3 ide? Do të jetë ky dokument publik?

4 Z. CADMAN: [Përkthim] Prokuroria ka kundërshtuar fjalinë
5 e fundit të paragrafit 30.

6 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne e kemi
7 shqyrtuar këtë çështje dhe i tërë paragrafi 30 duhet të
8 fshihet.

9 Z. CADMAN: [Përkthim] Dakord.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] A doni që ky
11 të jetë dokument publik?

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Po.

13 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Bolici?

14 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo, nuk kemi ndonjë gjë. Do ta
15 shikojmë më tutje në qoftë se përmenden emra, që nuk mendoj që
16 ka, ne do te vijmë të paraqesim komentet tona.

17 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Bowden.

18 Z. BOWDEN: [Përkthim] Jo, nuk kam ndonjë gjë tjetër.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Znj. Bolici,
20 ju lutem na jepni përgjigjen pasi të kthehemi nga pushimi.

21 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po.

22 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Do marrin një
23 pushim 45 minuta. Do të kthehemi në orën 10.30 dhe pastaj do
24 të trajtojmë çështjet që na mbetën.

25 Z. Cadman, kishit pyetje? Jo, dakord.

1 Atëherë seanca është e pezulluar.

2 --- Pauza fillon në orën 09.45

3 --- Seanca rifillon në orën 10.30

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Për sa i
5 përket provave të tjera të cilat janë paraqitur përmes z.
6 Reid, Trupi Gjykses vendos si më poshtë.

7 Për sa i përket Manualit të Praktikave të Zhvilluara të
8 TPNJ-së e pranojmë këtë dokument, pasi është pjesë e dëshmisë
9 së tij dhe seancës së pyetjeve që janë bërë.

10 Për sa i përket ERN10472901 dhe paragrafin 6 të gjykimit
11 të Haradinaj, Trupi Gjykses e kupton që në këtë rast aktet dhe
12 sjelljet e të akuzuarit do të interpretohen në kontekstin në
13 të cilin ka ndodhur dhe ZPS-ja pohon se është kontekst i cili
14 ka ndodhur përmes frikësimit të dëshmitarëve në Kosovë. Dhe
15 kjo çështje është diskutuar me të akuzuarin në atë kohë.

16 Trupi Gjykses mendon që, këto janë dy akuza në këtë akt
17 të akuzës që janë të lidhura me këtë çështje.

18 Z. Reid u pyet për këtë çështje dhe për këtë arsye Trupi
19 Gjykses mendon se, këto kanë vlera provuese. Mbrojtja ka pasur
20 mundësinë për t'i bërë pyetje dëshmitarit me qëllim që të mos
21 dëmtohej vlera provuese e tyre.

22 Po kështu në video, e cila është pjesë e transkriptit 24
23 janar 2022, është po kështu e pranuar si pjesë e paragrafit 6
24 të mbrojtjes së Haradinaj, të paraqitur në datën 3 prill 2008.

25 ZPS-ja kërkohet që ta paraqes këtë pasazh të paragrafit

1 6, i cili do të pranohet pjesërisht.

2 Për sa i përket pjesëve të dëshmisë së Inayatit, Trupi
3 Gjykues mendon se këto pasazhe mund të pranohen vetëm për të
4 vërtetuar besueshmërinë e dëshmitarit dhe të raportit të tij.
5 Dhe nuk janë për t'u trajtuar nga përbërja dhe për këtë arsye
6 Trupi Gjykues i pranon me këto kushte.

7 Znj. Sekretare, jepi një numër.

8 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,
9 udhëzuesi i TPIJ do të ketë numrin 2D13. Dokumentet e ZPS
10 video, do të ketë numrin P165. Pasazhet apo pjesët nga
11 Haradinaj do të kenë numrin P166.

12 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
13 ndjesë, 66?

14 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] 166.

15 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Dhe e
16 mëparshmja e kishte numrin 155 apo 165?

17 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] 165

18 Dhe transkripti IT-99-36 T924 deri në T1007 do të ketë
19 provën materiale P167. Transkripti IT-99-36 T1008 deri në
20 T1104 do të ketë numrin P168. Dhe e fundit, transkripti IT-99-
21 36 T3750 deri në T3822 do të ketë numrin P169. Faleminderit të
22 nderuar Gjykatës.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] 2D13 pranohet
24 si prova materiale, po kështu dhe P165 deri në P169.

25 Znj. Bolici, a keni përgjigje për sa i përket

1 klasifikimit të raportit të z. Reid?

2 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Po, i nderuar Gjykatës. Nuk kemi
3 dokument që të jetë dokument publik.

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Klasifikimi
5 është publik dhe mbrojtja e Haradinaj urdhërohet që ta
6 ngarkojë dokumentin e ngarkuar brenda 31 janarit me paragrafët
7 e redaktuar dhe sekretaria do ta shënoi pikërisht si të
8 redaktuar dhe me të njëjtin numër prove.

9 [Trupi gjykues dhe juristi këshillohen]

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ju kërkoj
11 ndjesë, nuk ka nevojë për ta ngarkuar këtë dokument, pasi
12 është dokument publik.

13 Me të përfunduar dëshminë e dëshmitarit të fundit, a
14 është e gatshme pala Mbrojtëse për ta mbyllur çështjen e saj?

15 Z. Cadman.

16 Z. CADMAN: [Përkthim] E di që z. Rees dëshiron që t'ju
17 bëjë një koment. Unë do të flas më pas. Por unë nuk jam gati
18 për ta përfunduar këtë çështje.

19 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Z. Rees.

20 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Të nderuar
21 Gjykatës, Mbrojtja nuk është gati për ta mbyllur. Ka ngelur
22 një problem për nxjerrjen e materialeve që nuk është zgjidhur.

23 Na janë dhënë udhëzime për t'u përgjigjur në hollësi
24 afatit kohor dhe kjo është ora 16.00 e ditës së sotme. Ne do
25 t'i përgjigjemi përpara orës 16.00, siç na është udhëzuar. Më

1 pas do të na duhet të presim vendimin e Trupit Gjykses dhe në
2 qoftë se jepet urdhër për t'i nxjerrë këto materiale, atëherë
3 do të shqyrtojmë se çfarë hapa të tjerë do të marrim pas
4 kësaj. Në qoftë se refuzohet nxjerrja, atëherë do të kërkojmë
5 të drejtën për ta apeluar apo do të shqyrtojmë mundësinë për
6 ta apeluar.

7 Në këtë fazë, ne nuk do ta paragjykojmë përfundimin e
8 këtij procesi, do të presim se cili do të jetë vendimi për
9 këtë kundërshtim që kemi bërë për çështjen e nxjerrjes.

10 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.
11 Do të presim mocionet tuaja të ditës së sotme.

12 Z. CADMAN: [Përkthim] Ne i kemi bërë parashtrimet tona
13 gjatë ditës së djeshme dhe po presim pikërisht vendimin tuaj.

14 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj.

15 Znj. Bolici, a keni ndonjë gjë për të shtuar?

16 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë nga ana jonë.
17 Faleminderit.

18 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Përpara se të
19 kalojmë tek çështja e rishikimit të afatit të paraburgimit, do
20 t'i kërkoj të dyja palëve Mbrojtëse.

21 Më datën 12 dhjetor 2021 kur kemi nxjerrë vendimin e
22 fundit për çështjen e rishikimit të paraburgimit, Trupi
23 Gjykses i ka kërkuar palëve dhe Sekretarisë që, brenda 24
24 janarit 2022 të japin parashtrimin e tyre të redaktuara, duke
25 mbajtur parasysh variantin e redaktuar publik të vendimit të

1 parandalimit. ZPS-ja dhe Sekretaria e kanë bërë këtë, por
2 Mbrojtja nuk e ka bërë.

3 Trupi Gjykses e urdhëron mbrojtjen e Gucatit dhe
4 Haradinajt që, të dorëzojnë versionet publike të redaktuara të
5 parashtrimeve të tyre 7F499 dhe F500 brenda 31 janarit 2022.
6 Redaktimet që ka kërkuar ky Trup Gjykses duhen të ndiqen në
7 këtë fushë.

8 Palëve u kërkohet që, t'i paraqesin në Sekretari brenda 4
9 shkurt 2022 problemet që mbeten për sa i përket saktësisë së
10 transkriptit, duke zbatuar procedurat.

11 Javën e kaluar ZPS-ja dhe Mbrojtja e Haradinajt, ranë
12 dakord që ta shtyjnë me 10 ditë periudhën e rishikimit të
13 paraburgimit dhe duke pritur vendimin e Gjykatës së Apelit për
14 këtë çështje. Mbrojtja e Gucatit donte akoma kohë për ta
15 shqyrtuar këtë.

16 Përpara se tua jap fjalën juve, do të bëj të qartë këtë:
17 Afati kohor për rishikim nuk do të shtyhet në qoftë se nuk e
18 kërkon këtë Mbrojtja e Gucatit. Paneli po kështu mban parasysht
19 që afati dy mujor i Nenit 41 të Ligjit, është i detyrueshëm
20 për tu zbatuar dhe nuk duhet të ndryshohet pa baza reale.

21 Në qoftë se Paneli vendos që ta shtyjë këtë kohë, do të
22 kërkojë që të vendosë një datë maksimum për ju dhe në qoftë se
23 Gjykata e Apelit nuk e jep vendimin e saj brenda kësaj
24 periudhe, Trupi Gjykses do të vazhdojë me rishikimin.

25 Z. Rees.

1 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Ju jam shumë
2 mirënjohës për këto tregues dhe për komentet e fundit që keni
3 bërë, të nderuar Gjykatës. Është në përputhje me shqetësimet
4 tona lidhur me procesin i cili duket sikur nuk ka fund.

5 Përmes korrespondencës *inter partes*, ne kemi arritur në
6 këtë propozim të përbashkët që: data në këtë fazë të mbetet 21
7 shkurt 2022 që, ZPS-ja t'i dërgojë parashtrimet e saj për
8 paraburgimin tre ditë pas vendimit të Gjykatës së Apelit ose
9 në momentin më të fundit në datën 14 shkurt 2022. Pala
10 Mbrojtëse do të përgjigjet brenda datës 17 shkurt 2022. Në
11 qoftë se nuk del vendimi i Gjykatës së Apelit përpara 13
12 shkurtit 2022, kërkesat e përbashkëta për ta shtyrë afatin e
13 rishikimit, do të paraqiten brenda 14 shkurt 2022.

14 Arsyeja se pse kemi propozuar këtë afat kohor, ishte pasi
15 ne mendojmë që ka kohë që Gjykata e Apelit ta nxjerrë vendimin
16 e saj përpara se të vijë data e caktuar për këtë rishikim. Ne
17 kemi rënë dakord për një afat më të shkurtër kohor duke u
18 bazuar në faktin që, na duhet koha e mjaftueshme për të parë
19 nëse do të dalë me vendim Gjykata e Apelit. Në qoftë se ata
20 nuk nxjerrin këtë vendim, ne do të bëjmë një diskutim *inter*
21 *partes* në atë fazë për të kërkuar një shtyrje të këtij afati
22 të rishikimit dhe këtë do ta bëjmë brenda datës 14 shkurt.

23 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] ZPS-ja është njoftuar nga
24 propozimi që ka bërë Mbrojtja e Gucatit dhe ka rënë dakord me
25 këtë propozim.

1 Z. CADMAN: [Përkthim] Po kështu edhe ne kemi rënë dakord.

2 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Ne do të
3 lëshojmë një urdhër më vonë, i cili do të mund të përfshijë
4 pikërisht këtë plan.

5 Tani t'i kthehemi çështjes së Konferencës mbi Ecurinë e
6 Çështjes. Do ta mbajmë këtë më datën 31 janar për të dëgjuar
7 parashtrimet lidhur me rendin e ditës që keni marrë javën e
8 shkuar, që ka shifrën F527. Në qoftë se ndonjëra nga palët
9 dëshiron që të bëjë parashtrim me shkrim përpara kësaj
10 konference, atëherë ato do të duhet të dorëzohen brenda orës
11 16.00 sot pasdite.

12 Trupi Gjykses jua ka bërë këtë njoftim paraprak me email
13 gjatë këtij viti.

14 Në qoftë se ZPS-ja kërkon leje për kundërprova, Trupi
15 Gjykses kërkon që kjo të bëhet në mënyrë gojore ditën e hënë
16 gjatë kësaj seance.

17 Znj. Bolici, nuk ka nevojë që të përgjigjeni në qoftë se
18 nuk jeni gati, por a e dini nëse do ta bëni një gjë të tillë?

19 ZNJ. BOLICI: [Përkthim] Jo, ne nuk presim që të bëjmë
20 ndonjë kërkesë për kundërprova.

21 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Në varësi të
22 parashtrimeve të bëra gjatë Konferencës mbi Ecurinë e
23 Çështjes, Trupi Gjykses do të lëshojë urdhra me shkrim dhe me
24 gojë ditën e hënë ose të martën, në datën 31 janar ose 1
25 shkurt.

1 A ka ndonjë çështje që doni të ngrini në këtë çështje?

2 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] A mund të
3 ngrejë një çështje, i nderuar Gjykatës?

4 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Po.

5 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Treguesit për
6 urdhra që do të bëhen përpara parashtrimeve me shkrim, kjo
7 përpara Konferencës mbi Ecurinë e Çështjes dhe mbi agjendën e
8 saj, na e kanë dhënë përpara kësaj kundërshtie lidhur me
9 procesin e nxjerrjes dhe mbi bazën e faktit që, parashikohet
10 që të mos ketë ndryshime të rrethanave dhe duke pasur parasysh
11 faktin që çështja e Mbrojtjes do të mbyllet brenda datës
12 [sipas përkthimit] 4.

13 Kjo nuk ka për të ndodhur në këtë moment, i nderuar
14 Gjykatës. E ngre këtë për të thënë që, në këto rrethana do të
15 ishte mirë që të mbahej parasysh agjenda e procedurave pas
16 dhënies së këtyre provave. Unë e di që kemi mbajtur një
17 diskutim paraprak në javën e parë të dhjetorit dhe në
18 Konferencën mbi Ecurinë e çështjes, ne do të vazhdojmë ta
19 ndihmojmë Trupi Gjykses për të planifikuar ditët e mëtejshme
20 në mënyrë provizionale, por nuk do të jemi në gjendje për të
21 parashikuar nëse çështja e Mbrojtjes do të mund të përfundojë
22 gjatë ditës së sotme.

23 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] Faleminderit.

24 Nuk ju është kërkuar që të bëni parashtrim me shkrim. Ne ju
25 kemi dhënë mundësinë edhe me sa kuptoj unë, nuk jeni në

1 gjendje që ta bëni. Megjithatë, ne do t'ju japim mundësinë për
2 ta bërë një gjë të tillë ditën e hënë, ndoshta me gojë dhe më
3 pas të presim se cilat janë urdhrat që do të nxirren ndërkohë.

4 E kuptoj në qoftë se të hënën do të duhet t'i ndryshojmë
5 këto plane dhe do t'i ndryshojmë sipas kësaj.

6 Z. REES: [Përkthim] [Përmes videolidhjes] Jemi të lumtur
7 që të japim ndihmën tonë më të mundshme Trupit Gjykues dhe
8 mund të bëjmë parashtrim me shkrim përpara Konferencës mbi
9 Ecurinë. Por, në qoftë se e bëjmë një gjë të tillë, do të jetë
10 e natyrës provizore, të përkohshme.

11 KRYETARI I TRUPIT GJYKUES SMITH: [Përkthim] E kuptoj dhe
12 është e drejta juaj. Ne ju inkurajojmë që ta bëni këtë,
13 pikërisht nëse dëshironi ta bëni këtë.

14 E njëjta gjë ka vlerë për juve z. Cadman.

15 Dhe për Prokurorinë.

16 A ka ndonjë gjë tjetër që doni të shtoni? Atëherë ju
17 falënderoj, e vlerësojmë kohën tuaj dhe do të takohemi ditën e
18 hënë në orën 9.30. Dhe ndoshta më të ecim me ritmet e duhura.
19 Faleminderit.

20 --- Seanca mbyllet në orën 10.45

21

22

23

24

25